



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.55

10 maj

2011

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Udhëzim i MPPT nr.7, datë 29.3.2011	Për procedurën e konvertimit të licencës kombëtare të personelit të mirëmbajtjes së avionit, në licencë të kufizuar të mirëmbajtësit aeronautik.....	2297
Udhëzim i MPPT dhe MMPAU nr.1037/1, datë 12.4.2011	Për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës mjedisore.....	2305
Udhëzim i MF nr.9, datë 26.4.2011	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.5, datë 30.1.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, lidhur me deklaratën individuale vjetore të të ardhurave.....	2319

UDHËZIM
Nr.7, datë 29.3.2011

**PËR PROCEDURËN E KONVERTIMIT TË LICENCËS KOMBËTARE TË PERSONELIT
TË MIRËMBAJTJES SË AVIONIT, NË LICENCË TË KUFIZUAR TË MIRËMBAJTËSIT
AERONAUTIK**

Në përputhje me nenin 102 pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 33 të ligjit nr.10 040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Qëllimi

Përcaktimi i procedurave për konvertimin e licencave kombëtare të personelit të mirëmbajtjes së avionit në licencë mirëmbajtësi aeronautik të kufizuar, si fazë kalimtare e procesit të njohjes së licencave brenda Zonës së Përbashkët të Aviacionit Europian.

2. Fusha e zbatimit

Ky udhëzim zbatohet për personelin e mirëmbajtjes së avionit, i cili zotëron një licencë kombëtare, të cilët para hyrjes në fuqi të udhëzimit të Ministrit nr.2, datë 2.2.2011 “Për procedurën e lëshimit, rinovimit, ndryshimit në objekt, pezullimit dhe revokimit të licencës së personelit të mirëmbajtjes së avionit”, ushtronin këto funksione në bazë të deklaramit të “Ripranimit në shërbim” (*Release to Service*).

2.1 Në këtë fazë kalimtare licencat e konvertuara do kenë vlerë vetëm në zonë kombëtare. Për momentin mbetet e papërcaktuar një datë, brenda së cilës të konvertohen licencat kombëtare.

2.2 Për teknikët e mirëmbajtjes në klasat motor dhe përbërës, siç parashikohet nga nënpjesa C e pjesës 66 të udhëzimit të Ministrit nr.16, datë 14.10.2008 “Për vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve të pajisjeve aeronautike dhe mbi aprovimin e organizatave dhe personelit të përfshirë në këto detyra”, mbeten në fuqi dispozitat e urdhrat të Ministrit nr.97, datë 19.6.1996 “Për rregulloren e licencimit të personelit fluturues dhe të mirëmbajtjes”.

3. Procedurat e konvertimit

3.1 Dokumentacioni që aplikanti do të paraqesë duhet të përmbajë:

3.1.1 Kërkesën për konvertim tek Autoriteti i Aviacionit Civil;

3.1.2 Formularin e plotësuar mod. 19 bis EASA (v. shtojca 1);

3.1.3 Dosjen përmbledhëse të aktivitetit të punës të raportuar në dosjen e konvertimit (v. shtojca 2).

Kjo dosje duhet të jetë e përgatitur nga kompania e mirëmbajtjes, pranë së cilës punon aplikanti dhe e firmosur nga menaxheri i cilësisë së kësaj kompanie.

3.2 Autoriteti i Aviacionit Civil vlerëson dokumentacionin shoqëruar në mbështetje të kërkesës dhe krahason të dhënat që përfshihen në dosjen e konvertimit me ato të dosjes së kandidatit, e depozituar në arkivin e Autoritetit.

3.3 Autoriteti i Aviacionit Civil, pasi vërteton vlefshmërinë e kësaj dosjeje dhe kufizimet e përfshira në të, lëshon LMA-në me kufizime në përmbajtje (mod. shtojca 3).

3.4 Autoriteti i Aviacionit Civil ka të drejtën të mos konvertojë ose të kufizojë privilegjet e LMA-së, nëse licenca që paraqitet për konvertim, rezulton të jetë lëshuar në mospërputhje me legjislacionin kombëtar.

3.5 Në procesin e konvertimit do merren parasysh dhe vlerësohen dhe licencat e lëshuara sipas formularit të parashikuar nga JAR 66 ose pjesa 66.

3.6 Kriteret e konvertimit të licencës kombëtare paraqiten si vijon:

3.6.1 Licencat kombëtare tip I mund të konvertohen në kategori A (shih shënimi 1);

3.6.2 Licencat kombëtare tip II mund të konvertohen në kategori B1/B2/C

(shih shënimi 1, shënimi 2).

Shënimi 1. Licencat e lëshuara me formularin JAR-66 ose EASA Formularin 26 nuk do konvertohen nëse zotëruesit e këtyre formularëve (JAA o EASA 26) nuk tregojnë të kenë marrë më parë një licencë kombëtare tip sipas pikave 1 ose 2.

Shënimi 2. Është e mundur të bëhet konvertimi në kategorinë B2 dhe/ose C nëse kërkuesit tregojnë që kanë ushtruar përkatësisht privilegjet e sektorit elektro-aeronautik dhe/ose në sektorin e “mirëmbajtjes bazë”.

3.7 Para konvertimit të licencës kombëtare në LMA të kufizuara, nuk është e mundur të bëhen modifikime në licencë (shtim kategorie/nënkategorie ose futje të aftësive të reja).

3.8 Në aktin e lëshimit të LMA-së së kufizuar, licenca kombëtare korresponduese anulohet zyrtarisht.

4. Kufizimet e paraqitura në LMA-në

LMA-të e lëshuara pas procesit të konvertimit do të përmbajnë kufizimet që derivojnë nga mungesat e njohurive bazë në lidhje me ato të parashikuara në programin mësimor të shtojcës III të pjesës 66. Kufizime të tilla nuk dëmtojnë privilegjet relative të kategorie/nënkategorie të paraqitura në licencën e konvertuar.

Kufizimet e parashikuara janë si më poshtë:

4.1 Për avionë me peshë maksimale në fluturim (M.T.O.W) më të lartë se 5700 kg (konvertim në kategoritë B1, B2, C)

Kufizime	E aplikueshme
Me përjashtim të avionëve të pajisur me turbohelikë	Për ata që s’kanë aftësi mbi avionë turbohelikë
Me përjashtim të avionëve të pajisur me helikë	Për ata që s’kanë aftësi mbi avionë me helikë
Me përjashtim të avionëve të pajisur me motor turboreaktiv	Për ata që s’kanë aftësi mbi avionë me motor turboreaktiv
Përjashtuar helikopterët	Për ata që s’kanë aftësi mbi helikopterë

Për të hequr kufizimet e lartpërmendura duhet të kalohen provimet përkatëse për modulet vijuese ose nënmodulet bazë:

Kufizimet	Moduli/nënmoduli
Me përjashtim të avionëve të pajisur me turbohelikë	M15.16 (motorët turbohelikë)
Me përjashtim të avionëve të pajisur me helikë	M17
Me përjashtim të avionëve të pajisur me motor turboreaktiv	M15
Përjashtuar helikopterët	M12, M15

4.2 Për avionët me peshë maksimale në fluturim (M.T.O.W) e njëjtë ose më pak se 5700 kg (konvertim në kategorinë B1/B2/C)

Kufizimet	E aplikueshme
Me përjashtim të avionëve të pajisur me turbohelikë	Për ata që nuk kanë aftësi mbi avionët me turbohelikë
Me përjashtim të avionëve të pajisur me helikë	Për ata që nuk kanë aftësi mbi avionët me helikë
Me përjashtim të avionëve të pajisur me motor turboreaktiv	Për ata që nuk kanë aftësi mbi avionët turboreaktivë
Përjashtuar helikopterët	Për ata që nuk kanë aftësi mbi helikopterët monomotorë
Përjashtuar avionët me MTOW mbi 5700 kg	Për të gjithë (pavarësisht nga aftësitë të përfshira në licencën kombëtare)
Përjashtuar helikopterët multimotorë	Për ata që nuk kanë aftësi mbi helikopterët multimotorë
Përjashtuar avionik të avionëve të mëdhenj	Për ata që kërkojnë kategorinë B2 nisur nga një licencë kombëtare që përmban aftësitë mbi avionët me MTOW më të vogël ose e njëjtë me 5700 kg ose mbi helikopterët monomotorë

Për të hequr kufizimet e lartpërmendura, do të duhet të kalohen provimet përkatëse mbi modulet e mëposhtme:

Kufizimet	Moduli/nënmoduli
Me përjashtim të avionëve të pajisur me turbohelikë	M15.16 (motorët turbohelikë)
Me përjashtim të avionëve të pajisur me helikë	M17
Me përjashtim të avionëve të pajisur me motor turboreaktiv	M15
Përjashtuar helikopterët	M12, M15
Përjashtuar avionët me MTOW mbi 5700 kg	Për Kat.B1.1: M3, M5, M6, M11a, M15 Për Kat.B1.2: M3, M5, M6, M11a, M16 Për Kat.B2: M3, M5, M6, M13, M14 Për Kat.C: M3, M5, M6, M11a, M13, M14, M15
Përjashtuar helikopterët multimotor	Për Kat.B1.3: M3, M5, M6, M12, M13, M15 Për Kat.B1.4: M3, M5, M6, M12, M16 Për Kat.B2: M3, M5, M6, M13, M14 Për Kat.C: M3, M5, M6, M12, M13, M14, M15
Përjashtuar avionik të avionëve të mëdhenj	M3, M4, M5, M13, M14

4.3 Për avionë me M.T.O.W. të njëjtë ose më të vogël se 5700 kg (konvertim në kategorinë A)

Kufizimet	E aplikueshme
Me përjashtim të avionëve të pajisur me turbohelikë	Për ata që nuk kanë aftësi mbi avionët me turbohelikë
Me përjashtim të avionëve të pajisura me helikë	Për ata që nuk kanë aftësi mbi avionët me helikë
Me përjashtim të avionëve të pajisur me motor turboreaktiv	Për ata që nuk kanë aftësi mbi avionët turboreaktivë
Përjashtuar helikopterët	Për ata që nuk kanë aftësi mbi helikopterët monomotorë
Përjashtuar avionët me MTOW mbi 5700 kg	Për të gjithë (pavarësisht nga aftësitë të përfshira në licencën kombëtare)
Përjashtuar helikopterët multimotorë	Për ata që nuk kanë aftësi mbi helikopterët multimotorë

Për heqjen e kufizimeve të lartpërmendura duhet të kalohen provimet relative në modulet e mëposhtme:

Kufizimet	Moduli/nënmoduli
Me përjashtim të avionëve të pajisur me turbohelikë	M15.16 (motorët turbohelikë)
Me përjashtim të avionëve të pajisura me helikë	M17
Me përjashtim të avionëve të pajisur me motor turboreaktiv	M15
Përjashtuar helikopterët	M12, M15
Përjashtuar avionët me MTOW mbi 5700 kg	M3, M5, M6, M11a
Përjashtuar helikopterët multimotorë	M3, M5, M6, M12

Legjenda:

Module 3. Bazat elektrike	12. Helicopter Systems (Mechanical)
Module 4. Bazat elektronike	13. Aircraft Systems (Avionic)
Module 5. Teknika digjitale	14. Propulsion (Avionic)
Module 6. Materiale dhe Hardware	15. Turbine Engine
Module 7. Praktikat e mirëmbajtjes	16. Piston Engine
Module 8. Aerodinamika bazike	17. Propellers
Module 9. Faktorët njerëzorë	
Module 10. Legjislacioni i aviacionit	
Module 11. Sistemet e avionëve (mekanikë)	

5. Aftësitë

Aftësitë që duhet të përfshihen në LMA, duhet të jenë të listuara në dosjen e konvertimit (all. 2). Ato përbëhen nga llojet e veçanta të avionëve të përfshira në licencën kombëtare për t'u konvertuar.

6. Kufizime në LMA: Shtesa kategorie ose njohje aftësie

6.1 Shtesa e kategorisë/nënkategorisë mund të kërkohej vetëm pasi të hiqen nga LMA-ja kufizimet, të pranishme në licencë, relative ndaj kategorisë/nënkategorisë së re.

Mundet të qëndrojnë në licencë, pas shtesës, ekskluzivisht kufizimet që nuk kanë lidhje në asnjë mënyrë me kategorinë/nënkategorinë e re subjekt shtesë.

6.2 Kufizimet e përmbajtura në LMA-në e “kufizuar” mund të hiqen duke dhënë provimet përkatëse në modulet e parashikuara nga shtojca III pjesa 66. Këto provime mund të jepen direkt pranë organizatave të aprovuara në pjesën 147 ose pranë autoritetit kompetent në vendet anëtare të EASA-s.

Për të arritur heqjen e një kufizimi në licencë duhet paraqitur kërkesa e veçantë tek Autoriteti i Aviacionit Civil, sipas modaliteteve të treguara në formularin 19bis EASA.

7. Raste të veçanta

Mund të paraqiten dy raste stafi teknik të huaj të mirëmbajtjes, i cili punon në një organizatë shqiptare mirëmbajtjeje të aprovuar, të cilët zotërojnë:

1. Licencë LMA- EASA (nga shtete anëtare të Bashkimit Europian)
2. Licenca të tjera jo nga shtete të Bashkimit Europian

Për personelin referuar pikës (1), Autoriteti i Aviacionit Civil mund të rivlerësojë licencat EASA, duke i pajisur me një licencë kombëtare me një numër serial të ndryshëm nga ato të konvertuara dhe/ose të lëshuara sipas pjesës 66.

Këto licenca do të kenë vlefshmëri 1-(një) vjeçare dhe ky proces do të jetë i vlefshëm deri në momentin që Republika e Shqipërisë do të jetë anëtare e EASA-s me të drejta të plota.

Për personelin referuar pikës (2), Autoriteti i Aviacionit Civil nuk do rivlerësojë licenca të tilla.

8. Shtojcat

Shtojcat bashkëlidhur janë pjesë e këtij udhëzimi dhe përmbajnë:

Shtojca 1: Kërkesa për lëshimin e LAM-së “së kufizuar” për konvertim (EASA Form 19bis)


Shtojca 2: Dosja e konvertimit

Shtojca 3: Modeli A.M.L. (Form 26)

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

SHTOJCA 1

<p>34g PJESE 66 - Licenca e kufizuar e mirëmbajtësit në aviacion (LMA)</p> <p>KËRKESË PËR LËSHIM. L M A. TË LIMITUAR PËR KONVERTIM</p>	<p>SHTOJCA 1</p>  <p>Autoriteti i Aviacionit Civil</p>																																			
<p>Të dhënat e kërkuarit:</p> <p>Mbiemër _____ Emër _____</p> <p>Adresa _____ Qyteti _____</p> <p>Telefoni _____ Celular/E-mail _____</p> <p>Kombësia _____ Vendi dhe data e lindjes _____</p>																																				
<p>Të dhënat e licencës kombëtare për t'u konvertuar në LMA të kufizuar:</p> <p>Licenca kombëtare nr. _____ Ndërmarrja e Mirëmbajtjes, pjesa 145 n. _____</p>																																				
<p>Informacion për ndërmarrjen që ka prezantuar skedën e konvertimit:</p> <p>Emërtimi i ndërmarrjes _____</p> <p>Adresa _____</p> <p>Numri i certifikatës së aprovimit të ndërmarrjes 145 _____</p> <p>Tel. _____ Fax _____</p>																																				
<p>Kërkoj lëshimin e një LMA-je të kufizuar, në kategoritë, nënkategori dhe lejime në vazhdimësi të treguara, për konvertim të licencës kombëtare nr. _____ e mbajtur nga unë:</p>																																				
<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th style="text-align: left;">Klasifikimi</th> <th style="text-align: center;">A</th> <th style="text-align: center;">B1</th> <th style="text-align: center;">B2</th> <th style="text-align: center;">C</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Avion me turbinë</td> <td style="text-align: center;"><input type="checkbox"/></td> <td style="text-align: center;"><input type="checkbox"/></td> <td style="text-align: center;">N/A</td> <td style="text-align: center;">N/A</td> </tr> <tr> <td>Avion me pistonë</td> <td style="text-align: center;"><input type="checkbox"/></td> <td style="text-align: center;"><input type="checkbox"/></td> <td style="text-align: center;">N/A</td> <td style="text-align: center;">N/A</td> </tr> <tr> <td>Helikopter me turbinë</td> <td style="text-align: center;"><input type="checkbox"/></td> <td style="text-align: center;"><input type="checkbox"/></td> <td style="text-align: center;">N/A</td> <td style="text-align: center;">N/A</td> </tr> <tr> <td>Helikopter me pistonë</td> <td style="text-align: center;"><input type="checkbox"/></td> <td style="text-align: center;"><input type="checkbox"/></td> <td style="text-align: center;">N/A</td> <td style="text-align: center;">N/A</td> </tr> <tr> <td>Avionik</td> <td style="text-align: center;">N/A</td> <td style="text-align: center;">N/A</td> <td style="text-align: center;"><input type="checkbox"/></td> <td style="text-align: center;">N/A</td> </tr> <tr> <td>Mjet fluturues</td> <td style="text-align: center;">N/A</td> <td style="text-align: center;">N/A</td> <td style="text-align: center;">N/A</td> <td style="text-align: center;"><input type="checkbox"/></td> </tr> </tbody> </table>		Klasifikimi	A	B1	B2	C	Avion me turbinë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	N/A	N/A	Avion me pistonë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	N/A	N/A	Helikopter me turbinë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	N/A	N/A	Helikopter me pistonë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	N/A	N/A	Avionik	N/A	N/A	<input type="checkbox"/>	N/A	Mjet fluturues	N/A	N/A	N/A	<input type="checkbox"/>
Klasifikimi	A	B1	B2	C																																
Avion me turbinë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	N/A	N/A																																
Avion me pistonë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	N/A	N/A																																
Helikopter me turbinë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	N/A	N/A																																
Helikopter me pistonë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	N/A	N/A																																
Avionik	N/A	N/A	<input type="checkbox"/>	N/A																																
Mjet fluturues	N/A	N/A	N/A	<input type="checkbox"/>																																
<p>Lejime të kërkuara (jo të kërkuara për kategorinë A)</p> <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th style="text-align: left;">Tipi i mjetit fluturues (tregoni motorin e instaluar)</th> <th style="text-align: center;">Cat. B1</th> <th style="text-align: center;">Cat. B2</th> <th style="text-align: center;">Cat. C</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td> </td> <td> </td> <td> </td> <td> </td> </tr> <tr> <td> </td> <td> </td> <td> </td> <td> </td> </tr> <tr> <td> </td> <td> </td> <td> </td> <td> </td> </tr> </tbody> </table>		Tipi i mjetit fluturues (tregoni motorin e instaluar)	Cat. B1	Cat. B2	Cat. C																															
Tipi i mjetit fluturues (tregoni motorin e instaluar)	Cat. B1	Cat. B2	Cat. C																																	
<p>1. Konfirmoj që informacionet e paraqitura në modulën prezent janë të vërteta.</p> <p>2. Konfirmoj gjithashtu që jam i vetëdijshëm për kufizimet e LMA-së që kërkoj dhe të faktit që për të marrë një licencë të pa kufizuar është e nevojshme që të mbrohen provimet që i përkasin, sipas mënyrës së përcaktuar nga ACAA.</p> <p>3. Jam gjithashtu i vetëdijshëm për faktin që prezantimi i deklaratave të falsifikuara paragjykon vlefshmërinë e licencës të lëshuar për konvertim.</p> <p>Mbiemër, emër _____ firma _____</p> <p>Vendi dhe data _____</p>																																				

SHTOJCA 2
SKEDA E KONVERTIMIT

Ndërmarrja _____ Certifikata e aprovimit, pjesa 145 _____								
SKEDA E KONVERTIMIT NË LMA TË KUFIZUAR								
Rezervuar ndërmarrjes së aprovuar sipas pjesës 145								Rezervuar për AAC
Mbiemër, emër	Data e lindjes	Titulli i studimit	Periudha që është kryer aktiviteti pranë ndërmarrjes (P 145)	Kurse të frekuentuara	Numri i autorizimit të certifikatës	Kategori e nënkategori e LMA-së së kërkuar	Tipi i mjetit fluturues¹	Kufizime për LMA
Firma e menaxherit të cilësisë _____ data _____								Përgjegjësi për AAC-në _____

¹ Tipat e mjeteve fluturuese duhet të tregohen në përputhje me *ratings* të parashikuar për vendosje në AML, si në shtojcën I të AMC të pjesës 66.

SHTOJCA 3
MODELI LMA (FORMA 26)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I AVIACIONIT
CIVIL SHQIPTAR**

ALBANIAN CIVIL AVIATION AUTHORITY

**LICENCË MIRËMBAJTJEJE
AVIACIONI**

*AIRCRAFT MAINTENANCE
LICENCE*

No.

KJO LICENCË NUK ËSHTË E NJOHUR NGA SHTETET ANËTAR
TË BE-SË
**THIS LICENCE IS NOT RECOGNISED BY EU MEMBER
STATES**

FORM 26

IV. Emri plotë i mbajtësit <i>IV. Full name of holder:</i>
IVa. Data e vendi i lindjes: <i>IVa. Date and place of birth:</i>
V. Adresa e mbajtësit <i>V. Address of holder:</i>
VI. Nacionaliteti i mbajtësit <i>VI. Nationality of holder:</i>
VII. Firma e mbajtësit <i>VII. Signature of holder:</i>
VIII. Autoriteti <i>VIII. Authority:</i>
LIC No:

VIII. Kushtet
VIII. Conditions:

1. Kjo licencë duhet të firmoset nga mbajtësi dhe të jetë e shoqëruar me dokument identiteti që përmban fotografi të mbajtësit të licencës.
This licence must be signed by the holder and be accompanied by an identity document containing a photograph of the licence holder.
2. Miratimi i çdo (nën)kategorie në faqen(t) e titulluar vetëm (NËN)KATEGORITË, nuk e lejon mbajtësin të lëshojë certifikatë për futjen në shërbim për një mjet fluturues.
Endorsement of any (sub)categories on the page(s) entitled (SUB)CATEGORIES only, does not permit the holder to issue a certificate of release to service for an aircraft.
3. Kjo licencë kur miratohet me *type rating* për një mjet fluturues përmbush synimin e ICAO annex 1
This licence when endorsed with an aircraft type rating meets the intent of ICAO annex 1.
4. Kjo licencë është e vlefshme brenda datës së specifikuar në faqen e limitimit përveç se paraprakisht pezullohet ose revokohet.
This licence remains valid until the date specified on the limitation page unless previously suspended or revoked.

LIC No:

IX. (NËN)KATEGORITË <i>IX. (SUB)CATEGORIES</i>				
Vlefshmëria: <i>Validity:</i>				
	A	B1	B2	C
Avionë me turbinë <i>Aeroplanes Turbine</i>			n/a	n/a
Avionë me piston <i>Aeroplanes Piston</i>			n/a	n/a
Helikopter me turbinë <i>Helicopters Turbine</i>			n/a	n/a
Helikopter me piston <i>Helicopters Piston</i>			n/a	n/a
Avioniks <i>Avionics</i>	n/a	n/a		n/a
Avion <i>Aircraft</i>	n/a	n/a	n/a	
Reserv <i>Reserved</i>				
LIC No:				

X. Nënshkrimin e lëshimit të zyrtarit dhe data <i>X. Signature of issuing officer & date</i>		
XI. Vulë ose shenjë e autoritetit që e lëshon: <i>XI. Seal or stamp of issuing Authority:</i>		
XII. "TYPE RATING" e mjetit fluturues <i>XII. AIRCRAFT TYPE RATINGS</i>		
Tipi ose grupi i mjeti fluturues <i>A/C Type or Group</i>	Kategoria <i>Category</i>	Vula zyrtare dhe data <i>Official Stamp & Date</i>
LIC No.		

XIII. KUFIZIMET <i>XIII. LIMITATIONS</i>
<p>E vlefshme deri më: <i>Valid until:</i></p> <p>LIC No:</p>

XIV. Privilegjet kombëtare jashtë fushëveprimit të pjesës-66, në përputhje me legjislacionin kombëtar <i>XIV. National privileges outside the scope of Part-66, in accordance with [National Legislation]</i>
<p>Vula zyrtare dhe data <i>Official Stamp & Date</i></p> <p>LIC No:</p>

<p>Lënë bosh me qëllim <i>Intentionally Left Blank</i></p>
--

UDHËZIM
Nr.1037/1, datë 12.4.2011

PËR VLERËSIMIN DHE MENAXHIMIN E ZHURMËS MJEDISORE

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, në përputhje me ligjin nr.9658, datë 18.12.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe midis Komunitetit Europian dhe Shteteve Anëtare, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Islandës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Serbisë, Republikës së Malit të Zi, ish Republikës së Jugosllave të Maqedonisë, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë dhe Misionit Administrativ të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, mbi krijimin e një Zone të Përbashkët Europiane të Aviacionit”,

UDHËZOJ:

Neni 1
Objektivat

1. Qëllimi i këtij udhëzimi do të jetë të përcaktojë një qëndrim të përbashkët me qëllim për të shmangur, parandaluar ose zvogëluar në një bazë prioriteti efektet e dëmshme, duke përfshirë edhe bezdisjen, për shkak të ekspozimit ndaj zhurmës mjedisore. Për këtë qëllim, këto veprime do të zbatohen në mënyrë progresive:

a) Përcaktimi i ekspozimit ndaj zhurmës mjedisore, përmes hartës së zhurmave, nga metodat e vlerësimit sipas këtij udhëzimi;

b) Të sigurojë që informacioni mbi zhurmën mjedisore dhe efektet e saj janë vënë në dispozicion të publikut;

c) Realizimi i planeve të veprimit, të bazuar mbi rezultatet e hartës së zhurmave, me qëllim parandalimin dhe zvogëlimin e zhurmës mjedisore kur është e nevojshme, veçanërisht kur nivelet e ekspozimit mund të shkaktojnë efekte të dëmshme në shëndetin e njeriut dhe në ruajtjen e cilësisë së mjedisit nga zhurma, atje ku kjo cilësi e mjedisit mund të jetë e mirë.

2. Ky udhëzim, gjithashtu, duhet të synojë të ofrojë një bazë për marrjen e masave për të reduktuar zhurmën e emetuar nga burimet e mëdha, në veçanti të mjeteve dhe infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore, avionëve, pajisjeve dhe makinerive të lëvizshme.

Neni 2
Qëllimi

1. Ky udhëzim zbatohet për zhurmën mjedisore, ndaj të cilës njerëzit ekspozohen në veçanti në zonat në ndërtim e sipër, në parqet publike ose zonat e tjera të qeta në një grumbullim, në fusha të qeta në vendet e hapura, afër shkollave, spitaleve dhe objekteve dhe fusha të tjera të ndjeshme ndaj zhurmave.

2. Ky udhëzim nuk do të zbatohet për zhurmën e shkaktuar nga vetë personi i ekspozuar, zhurma nga aktivitetet e brendshme, nga zhurma të krijuara nga fqinjët, zhurmës në vende të punës ose zhurma brenda mjeteve të transportit ose për shkak të aktiviteteve ushtarake në zonat ushtarake.

Neni 3
Përkufizimet

Për qëllime të këtij udhëzimi:

a) “Zhurmë mjedisore” do të thotë tingull i jashtëm, i padëshiruar ose i dëmshëm në natyrë, i krijuar nga aktivitetet njerëzore, duke përfshirë edhe zhurmën e emetuar nga mjetet e transportit, trafikut rrugor, trafikut hekurudhor e trafikut ajror, si dhe nga zonat e aktiviteteve industriale.

- b) “Efekte të dëmshme” do të thotë efekte negative në shëndetin e njeriut.
- c) “Bezdi” do të thotë shkalla e zhurmës bezdisëse në vend, e përcaktuar me anë të shqyrtimeve në terren.
- d) “Tregues i zhurmës” do të thotë shkalla fizike që përshkruan zhurmën mjedisore, e cila ka një raport me një efekt të dëmshëm.
- e) “Vlerësim” do të thotë çdo metodë që përdoret për llogaritje, parashikim, vlerësim apo matje të vlerës së treguesit të zhurmës ose efekteve të dëmshme të lidhura me to.
- f) “ L_{dpm} ” (tregues i zhurmës në ditë-pasditë-natën) nënkupton treguesin e zhurmës bezdisëse të përgjithshëm, siç përcaktohet më tej në shtojcën I.
- g) “ L_{dite} ” (tregues i zhurmës ditën) nënkupton treguesin e zhurmës bezdisëse gjatë ditës, siç është përcaktuar më tej në shtojcën I.
- h) “ $L_{pasdite}$ ” (tregues i zhurmës pasdite) nënkupton treguesin e zhurmës bezdisëse gjatë periudhës së pasdites, siç përcaktohet më tej në shtojcën I.
- i) “ L_{nate} ” (tregues i zhurmës gjatë natës) nënkupton treguesin e zhurmës për prishjen e gjumit, siç përcaktohet më tej në shtojcën I.
- j) “Raporti dozë-efekt” nënkupton marrëdhënien mes vlerës së një treguesi të zhurmës dhe efektit të dëmshëm.
- k) “Grumbullim” do të thotë pjesë e territorit brenda Republikës së Shqipërisë, që ka një popullsi më të madhe se 100 000 persona dhe një dendësi të popullsisë në një masë të tillë që të mund të klasifikohet si zonë urbane, sipas legjislacionit në fuqi.
- l) “Zonë e qetë në një grumbullim” do të thotë një zonë e kufizuar nga autoriteti kompetent, e cila për shembull nuk është e ekspozuar ndaj një vlere të L_{dpm} ose të një tjetër treguesi zhurme më të madh se sa një vlerë e përcaktuar nga organet kompetente, nga çdo burim zhurme.
- m) “Zonë e qetë në vendet e hapura” do të thotë një zonë e kufizuar nga autoriteti kompetent, që nuk shqetësohet nga zhurmat prej trafikut, industrisë apo aktiviteteve rekreative.
- n) “Rrugë kryesore” do të thotë një rrugë rajonale, kombëtare ose ndërkombëtare e përcaktuar nga shteti, në të cilën kalojnë më shumë se tre milionë automjete në vit.
- o) “hekurudhë kryesore” do të thotë një hekurudhë e përcaktuar nga shteti, në të cilën kalojnë më shumë se 30 000 trena në vit.
- p) “Aeroport kryesor” do të thotë një aeroport civil i përcaktuar nga shteti, i cili ka më shumë se 50 000 lëvizje në vit (lëvizje është një ngritje ose një ulje), duke përjashtuar lëvizjet për qëllime të trajnimit të avionëve të lehtë.
- q) “Harta e zhurmave” do të thotë paraqitja e të dhënave në një situatë zhurmash ekzistuese ose të parashikuar në termat e treguesit të zhurmës, që tregon shkeljet e çdo vlere kufitare relevante në fuqi, numri i njerëzve të prekur në një zonë të caktuar, ose numri i banesave të ekspozuara ndaj vlerave të caktuara të treguesit të zhurmës në zonat e caktuara;
- r) “Harta strategjike e zhurmave” do të thotë një hartë e përpiluar për vlerësimin global të ekspozimit të zhurmës në zonën e caktuar për shkak të burimeve të ndryshme të zhurmës ose për parashikimin e përgjithshëm të zhurmave në një zonë të tillë.
- s) “Vlerë kufitare” nënkupton vlerën e L_{dpm} ose L_{nate} , dhe kur është e nevojshme të L_{dite} dhe $L_{pasdite}$, të përcaktuara nga autoritetet kompetente, tejkalmi i së cilës bën që autoritetet kompetente të marrin në konsideratë apo të zbatojnë masa për zbutjen e tyre; vlerat kufitare mund të jenë të ndryshme për lloje të ndryshme të zhurmës (zhurmë rrugësh, hekurudhash, trafikut ajror, zhurmat industriale etj.), mjedise të ndryshme dhe ndjeshmëri të ndryshme të popullatës ndaj zhurmës; ato mund të jenë të ndryshme për situata ekzistuese dhe për situata të reja (kur ka një ndryshim të situatës lidhur me burimin e zhurmës ose shfrytëzimin e rrethinës).
- t) “Plane të veprimit” do të thotë plan i hartuar për të menaxhuar çështjet dhe efektet e zhurmës, duke përfshirë edhe zvogëlimin e zhurmës, nëse është e nevojshme.
- u) “Planifikimi akustik” do të thotë kontrolli i zhurmave të ardhshme me masa të planifikuara, si për shembull planifikimin e përdorimit të tokës, sistemet inxhinierike për trafikon, planifikimin e trafikut, reduktimin e zhurmave me masa për izolimin e tingullit dhe kontrollit të zhurmës në burime.

v) "Publiku" do të thotë një ose më shumë persona fizikë apo juridikë, si dhe në përputhje me legjislacionin për shoqatat, organizatat ose grupimet.

w) Aneksat I, II, III, IV dhe V të përshkruara në këtë udhëzim, janë pjesë integrale e tij.

Neni 4

Zbatimi dhe përgjegjësitë

Autoritetet kompetente do të jenë përgjegjëse për:

a) të bërë dhe, kur është e përshtatshme, për të aprovuar hartat e zhurmave dhe planet e veprimit për grumbullimet, rrugët kryesore, hekurudhat dhe aeroportet e mëdha;

b) mbledhjen e hartave të zhurmës dhe planeve të veprimit.

Neni 5

Treguesit e zhurmës dhe zbatimi i tyre

1. Autoritetet kompetente mund të aplikojnë treguesit e zhurmave L_{dpm} dhe L_{nate} të referuar në aneksin I për përgatitjen dhe rishikimin e hartës strategjike të zhurmës, në pajtim me nenin 7.

2. Mund të përdoren tregues plotësues të zhurmës për rastet e veçanta, si ato të listuara në shtojcën I (3).

3. Për planifikimin dhe caktimin e zonave të zhurmave akustike, mund të përdoren tregues të tjerë të zhurmës në vend të L_{dpm} dhe L_{nate} .

Neni 6

Metodat e vlerësimit

1. Vlerat e L_{dpm} dhe L_{nate} do të përcaktohen me anë të metodave të vlerësimit të përcaktuara në aneksin II.

2. Metodat e vlerësimit për përcaktimin e L_{dpm} dhe L_{nate} do të vendosen nga organet kompetente në pajtim me procedurën e përcaktuar në nenin 13 (2) nëpërmjet një rishikimi të shtojcës II. Derisa këto metoda të jenë përshtatur, mund të përdoren metoda të vlerësimit të përshtatura në përputhje me aneksin II dhe bazuar në metodat e përcaktuara në legjislacionin aktual. Në rast të tillë, duhet të provohet se këto metoda japin rezultate të barabarta me rezultatet e arritura me metodat e përcaktuara në paragrafin 2.2 të shtojcës II.

3. Efektet e dëmshme mund të vlerësohen me anë të marrëdhënieve dozë-efekt të referuara në aneksin III.

Neni 7

Hartat strategjike të zhurmës

1. Brenda 5 viteve nga data e miratimit të këtij udhëzimi duhet të jenë përgatitur hartat strategjike të zhurmës, duke paraqitur situatën në vitin e kaluar kalendarik dhe, kur është e nevojshme, të jenë miratuar nga autoritetet kompetente, për të gjitha bashkësitë e popullsisë me më shumë se 250 000 banorë dhe për të gjitha rrugët e mëdha, të cilat kanë më shumë se gjashtë milion automjete në vit; hekurudhat e mëdha, të cilat kanë kalime të më shumë se 60 000 trenave në vit dhe aeroportet e mëdha në territorin e tyre.

2. Brenda 10 viteve nga data e miratimit të këtij udhëzimi dhe, më pas çdo pesë vjet, duhet të përgatiten hartat e zhurmës strategjike, duke paraqitur situatën në vitin e kaluar kalendarik dhe, kur është e nevojshme, të jenë miratuar nga autoritetet kompetente për të gjitha grumbullimet dhe për të gjitha rrugët kryesore dhe hekurudhat e mëdha në territorin e tyre.

3. Hartat strategjike të zhurmës duhet të përmbushin kërkesat minimale të përshkruara në aneksin IV.

4. Autoritetet kompetente do të bashkëpunojnë me autoritetet fqinje për hartimin e hartave të zhurmës strategjike pranë kufijve.

5. Hartat strategjike të zhurmës duhet të rishikohen dhe, nëse është e nevojshme, të korrigjohen, së paku çdo pesë vjet pas datës së përgatitjes së tyre.

Neni 8

Planet e veprimit

1. Plane veprimi për menaxhimin e çështjeve të zhurmës dhe efekteve të saj, duke përfshirë edhe zvogëlimin e zhurmës, nëse është e nevojshme, do të hartohen për:

A. Vendet pranë rrugëve kryesore, të cilat kanë më shumë se gjashtë milionë automjete në vit, hekurudhat e rëndësishme, të cilat kanë udhëtime të më shumë se 60 000 trenave në vit, si dhe aeroportet kryesore;

B. Bashkësitë e popullsisë me më shumë se 250 000 banorë. Plane të tilla duhet të synojnë mbrojtjen e zonave të qeta kundër një rritjeje të zhurmave.

Masat në lidhje me planet duhet të adresojnë prioritetet, e sidomos ato të cilat mund të identifikohen nga tejkalimi i çdo vlere kufitare përkatëse ose në bazë të kritereve të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi dhe zbatohen në mënyrë të veçantë në zonat më të rëndësishme, të themeluara sipas hartës së zhurmave strategjike.

2. Duhet përpiluar plane veprimi, veçanërisht për të adresuar prioritetet që mund të identifikohen nga tejkalimi i çdo vlere kufitare përkatëse ose në bazë të kritereve të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për bashkësitë e popullsisë dhe për rrugët dhe hekurudhat kryesore.

3. Planet e veprimit do të plotësojnë kërkesat minimale të shtojcës V.

4. Planet e veprimit do të shqyrtohen dhe rishikohen, nëse është e nevojshme, kur ndodh një zhvillim i madh që ndikon në situatën ekzistuese të zhurmës dhe të paktën çdo 5 vjet pas datës së miratimit të tyre.

5. Planet mjedisore të mjedisit janë publike dhe i vihen në dispozicion publikut sipas kërkesës, për t'u konsultuar me to.

Neni 9

Informacion për publikun

1. Publiku ka të drejtë të informohet për hartat strategjike të zhurmës dhe, kur është e nevojshme, hartat strategjike të zhurmës të adoptuara, si dhe planet e veprimit që janë hartuar për çështjen mjedisore në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Ky informacion duhet të jetë i qartë, i kuptueshëm dhe i arritshëm. Autoritetet kompetente duhet të përpilojnë një përmbledhje që paraqet çështjet më të rëndësishme.

Neni 10

Aspekte që mbulohen nga plani i veprimit

1. Planet e veprimit për zhurmën mjedisore duhet të përmbajnë masa për implementimin e strategjive për aspekte të tilla si:

A. Qëllimet afatgjata dhe afatmesme për reduktimin e numrit të personave të dëmtuar nga zhurmat e mjedisit, veçanërisht duke marrë parasysh zonat përkatëse;

B. Masa të tjera për uljen e zhurmës mjedisore të emetuara nga burime të veçanta, nga pajisje të veçanta në natyrë, mjete dhe infrastrukturës së transportit dhe të kategorive të caktuara të aktiviteteve industriale, duke u mbështetur mbi këto masa të zbatuara tashmë ose që janë në diskutim për miratim;

- C. Mbrojtjen e zonave të qeta në vendet e hapura.
2. Pas përpilimit të hartave të zhurmës strategjike, do të rishikohet:
- mundësia për një lartësi matje 1,5 metër në shtojcën I, paragrafi 1, në lidhje me zonat ku ka shtëpi njëkatëshe,
 - kufiri i ulët për numrin e parashikuar të njerëzve të ekspozuar në grupe të ndryshme të L_{dpm} dhe L_{nate} në aneksin VI.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE
TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Fatmir Mediu

ANEKSI I
ZHURMA. TREGUESIT
(Referuar në nenin 5)

1. Përcaktimi i nivelit-ditor në mbrëmje-natë L_{den}
Niveli ditë-mbrëmje-natë L_{dpm} në decibel (dB) është përkufizuar me formulën e mëposhtme:

$$L_{den} = 10 \lg \frac{1}{24} \left(12 * 10^{\frac{L_{day}}{10}} + 4 * 10^{\frac{L_{evening} + 5}{10}} + 8 * 10^{\frac{L_{night} + 10}{10}} \right)$$

Ku:

- L_{dita} është niveli mesatar i zërit i ponderuar në mënyrë afatgjatë, sipas ISO 1996-2: 1987, i përcaktuar gjatë gjithë periudhave ditore të vitit;
- $L_{pasdite}$ është niveli mesatar i zërit i ponderuar në mënyrë afatgjatë sipas ISO 1996-2: 1987, i përcaktuar gjatë gjithë periudhave të mbrëmjes në vit;
- L_{natat} është niveli mesatar i zërit i ponderuar në mënyrë afatgjatë sipas ISO 1996-2: 1987, i përcaktuar gjatë gjithë periudhave të natës të një viti;

Ku:

- Dita është llogaritur 12 orë, mbrëmja katër orë dhe nata tetë orë.
- Fillimi i ditës llogaritet nga ora 07:00 deri në orën 19:00; fillimi i mbrëmjes llogaritet nga ora 19.00 deri në orën 23.00 dhe fillimi i natës llogaritet nga ora 23:00 deri në orën 07:00;
- Viti është viti përkatës për sa i përket emetimit të tingullit dhe një vit mesatar i rrethanave meteorologjike;

Dhe në të cilin:

- janë konsideruar tingujt e rastësishëm, që do të thotë se nuk merren parasysh tingujt që janë pasqyruar në fasadën e banesës në shqyrtim (si rregull i përgjithshëm, kjo nënkupton një korrigjim 3 dB në rastin e matjes).

Lartësia e pikës së vlerësimit të L_{dpm} varet nga aplikimi:

- në rastin e llogaritjes për qëllimet e hartave strategjike të zhurmës në lidhje me ekspozimin ndaj zhurmës në dhe pranë ndërtesave, pikat e vlerësimit duhet të jenë $4,0 \pm 0,2$ m (3,8 në 4,2 m) mbi tokë dhe në fasadën më të ekspozuar; për këtë qëllim, fasada më e ekspozuar do të jetë muri i

jashtëm mbi burimin specifik më të afërt të zhurmës; për qëllime të tjera mund të bëhen zgjidhje të tjera;

- në rastin e llogaritjes për qëllimet e hartave strategjike të zhurmës në lidhje me ekspozimin ndaj zhurmës në dhe pranë ndërtesave, mund të zgjidhen lartësi të tjera, por ato nuk duhet të jenë më pak se 1,5 m mbi tokë, dhe rezultatet duhet të korrigjohen në përputhje me një lartësi prej 4 m ekuivalent;

- për qëllime të tjera të tilla, si planifikime akustike dhe zonimi i zhurmës mund të zgjidhen lartësi të tjera, por ato nuk duhet të jenë më pak se 1,5 m mbi tokë, për shembull për:

- zonat rurale me shtëpi njëkatëshe;
- hartimin e masave lokale me qëllim reduktimin e ndikimit të zhurmave në banesa të veçanta;

- harta zhurme të detajuar të një zone të kufizuar, duke treguar ekspozimin ndaj zhurmës së banesave individuale.

2. Përcaktimi i treguesit të zhurmës së natës

- Indikator i zhurmës së natës L_{nata} është ponderimi-A afatgjatë i nivelit mesatar të zërit, sipas ISO 1996-2: 1987, përcaktuar gjatë gjithë periudhave të netëve të një viti;

Në të cilat:

- nata është tetë orë siç është përcaktuar në paragrafin 1;
- një vit është një vit përkatës për sa i përket emetimit të zërit dhe një vit mesatar në lidhje me rrethanat meteorologjike, siç përcaktohet në paragrafin 1;
- zhurmat aksidentale konsiderohen, sikur është përcaktuar në paragrafin 1;
- pika e vlerësimit është e njëjtë si për L_{dpn} .

3. Treguesit plotësues të zhurmës

Në disa raste, përveç L_{dpn} dhe L_{nata} dhe, kur është e përshtatshme L_{dpn} dhe $L_{pasdite}$, mund të jetë i dobishëm përdorimi i treguesve të veçantë lidhur me zhurmën dhe vlerat kufitare. Disa shembuj janë dhënë më poshtë:

- burimi i zhurmës në shqyrtim vepron vetëm për një përqindje të vogël të kohës (për shembull, më pak se 20% të kohës mbi totalin e periudhave ditore në një vit, totali i periudhave të mbrëmjes në një vit, ose gjithsej të periudhave të netëve në një vit);

- numri mesatar i ngjarjeve të zhurmës në një ose më shumë periudha është shumë i ulët (për shembull, më pak se një ngjarje zhurme në një orë, një ngjarje të zhurmës mund të përcaktohet si një zhurmë që zgjat më pak se pesë minuta, shembujt janë të zhurmës nga një tren apo aeroplan që kalon);

- përmbajtja e frekuencës së ulët të zhurmës është i fortë;

L_{Amax} , ose SEL (niveli i ekspozimit të zërit) për mbrojtjen e periudhës së natës në rastin e kulmeve të zhurmës;

- mbrojtje shtesë në fundjavë apo në pjesë të veçanta të vitit;

- mbrojtje shtesë në periudhën e ditës;

- mbrojtje shtesë në kohën e mbrëmjes;

- një kombinim i zhurmave nga burime të ndryshme;

- zonat e qeta në vendet e hapura;

- zhurma përmban komponentë të fortë tonalë;

- zhurma ka një karakter të menjëhershëm.

ANEKSI II
METODA VLERËSIMI PËR TREGUESIT E ZHURMAVE
(të referuara në nenin 6)

1. Hyrje

Vlerat e L_{dpn} dhe L_{nate} mund të përcaktohen si me llogaritje ashtu edhe me matje (në pozicionin e vlerësimit).

Për parashikimet aplikohen vetëm llogaritjet.

Llogaritjet e përkohshme dhe metodat e matjes janë të parashikuara në paragrafët 2 dhe 3.

2. Metodat për llogaritjen e përkohshme të L_{dpn} dhe L_{nate}

2.1 Metodat e rekomanduara të llogaritjes të përkohshme

2.1.1 Metoda e segmentimit

Metoda e përshkruar është bazuar në supozimin themelor që zhurma mund të llogaritet sikur aeroplani të ishte duke ndjekur një udhë të drejtë dhe fluturon në një lartësi konstante, me një fuqi konstante dhe të vazhdueshme dhe me shpejtësi konstante. Metodat e përafërta për të korrigjuar nivelin e llogaritur të zhurmës (L_{AE} ose L_{max}) në sektorë të caktuar, janë plotësues të dhënë për të gjithë dokumentin.

Një teknikë e përdorur në disa programe kompjuterike më të avancuara për llogaritjen e nivelit të ekspozimit të tingujve është metoda e segmentimit. Rruga e fluturimit është e ndarë në segmente, ku secili prej tyre i plotëson kërkesat për të dhënat, duke përdorur formatin e të dhënave të zhurmës (rrugën e drejtë të fluturimit, shpejtësi konstante dhe vendosjen e fuqisë). Niveli i ekspozimit të tingujve është llogaritur për secilin segment dhe korrigjuar për gjatësinë e fundme të segmentit para se kontributet nga të gjitha segmentet të jenë shtuar. Përdorimi i segmentimit zgjidh shumë probleme kompjuterike, si p.sh., efektin e ndryshimit në vendosjen e fuqisë dhe efektin e kohëzgjatjes së ndryshimeve në lidhje me një trajektore të një fluturimi në kthesë. Shpenzimet për shkallët e shumta të segmentimit rritin kohën e kompjuterit krahasuar me metodën e zakonshme.


2.1.2 Korrigjimi për rregullimin e ndryshimit të fuqisë

Nëse segmentimi (siç është përshkruar në pikën 2.1.1 më lart) nuk është përdorur, mund të jetë e nevojshme për të bërë parashikime për ndryshime në L_{AE} dhe L_{Amax} për shkak të ndryshimeve në vendosjen e fuqisë.

Nëse vendosja e fuqisë dhe kështu emetimi i zhurmës është konstant ose ndryshon shumë ngadalë në pjesën e rëndësishme të interesuar të matjes së zhurmës, është e arsyeshme supozimi për të përdorur vendosjen e fuqisë në pikën P si një përfaqësues në të gjithë fluturimin.

Megjithatë, nëse ndryshime të shpejta të rëndësishme në vendosjen e fuqisë vërehen, ky parim do të çojë në ndërprerje të kontureve për zhurmën e llogaritur, siç është treguar në figurën 1 me linjat e thyera. Kjo natyrisht nuk është e saktë për nivelin e ekspozimit të tingullit L_{AE} , i cili është bazuar në nivelin e integruar të kohës së të gjithë fluturimit, kështu pra konturet e ekspozimit të zhurmës duhet të duken më shumë si linjat e ngurta në figurën 1. Konturet në figurën 1 janë vetëm shembuj për të paraqitur problemin. Shumë shpesh programet, të cilat nuk përmbajnë një metodë për llogaritjen e efektit të ndryshimeve të fuqisë së motorit, përdorin ndryshime graduale të fuqisë së të dhënave e të performancës, për të simuluar ndryshimet brenda kontureve të zhurmës.

Figura 1 - Korrigjimi për ndryshime në parametrat e fuqisë



Gjithashtu, konturet në rastin e niveleve maksimale do të jenë të pandërprera. Nivelet maksimale në zonën e ndikuar nga ndryshimi i fuqisë mund të përcaktohen nga pjesët e tjera të fluturimit sesa nga pika më e afërt e llogaritjes.


Metoda e llogaritjes duhet të përfshijë një algoritëm, i cili parashikon efektin e ndryshimeve në fuqi me një saktësi të arsyeshme.

Një parashikim i saktë i nivelit të zhurmës në një pikë të llogaritjes afër rrugës së fluturimit, në të cilën marrin pjesë ndryshime në fuqi, është një çështje shumë e komplikuar. Një parashikim i tillë duhet të marrë parasysh sistemin udhëzues për secilin avion më vete dhe të gjitha ndryshimet në fuqi gjatë fluturimit. Sistemi udhëzues do të ndryshojë nga njëri avion në tjetrin me diferenca të mëdha, veçanërisht ndërmjet avionëve reaktivë me emetime maksimale të zhurmës 30° - 60° nga bishti, avionëve me helikë, të cilët janë shumëdrejtimësh dhe helikopterëve, që mund të kenë një shpërndarje maksimale gati kudo rreth tij dhe një sistem udhëzues, të cilët nuk janë simetrik rreth boshtit, siç janë tipat e avionëve me krah.

Hapi i parë është të përcaktojmë këndin θ_m (në $^{\circ}$) midis drejtimit të avionit dhe të drejtimit P_mB . Pika P_m është pika ku fuqia është ndryshuar, dhe pika B është pika e llogaritjes, siç është paraqitur në figurën 2.

Nëse P_mB është tri herë më shumë se BP, efekti i ndryshimeve në vendosjen e fuqisë zakonisht mund të injorohet kur llogaritet L_{AE} , ndërsa nëse është dy herë më shumë se BP, zakonisht është e mjaftueshme gjatë llogaritjes L_{AMAX} .

Figura 2 — Përcaktimi i parametrave gjeometrikë për parashikim të ndryshimeve në fuqi.



Efekti i ndryshimeve në vendosjen e fuqisë në ekspozimin e nivelit të zërit LAE është llogaritur në bazë të formulës 2.

$$L_{AE}(d) = 10 \log \left[\frac{L_{AE,1}(d)}{(F(\theta_m))10^{10}} + \frac{L_{AE,2}(d)}{(1-F(\theta_m))10^{10}} \right]$$

(2)

Ku:

$L_{AE,1}(d)$ është niveli i ekspozimit të tingujve në një distancë (d) në vendosjen e fuqisë përpara Pm.

$L_{AE,2}(d)$ është niveli i ekspozimit të tingujve në një distancë (d) në vendosjen e fuqisë pas Pm.

$F(\theta_m)$ është përqindja e energjisë së tingullit nga $\theta = 0^\circ$ të $\theta = \theta_m$.

Përqindja e energjisë së tingullit $F(\theta)$ nga 0° deri në θ është llogaritur në bazë të formulës

3.

$$F(\theta) = \frac{\theta}{180} - \frac{\sin(\theta) \cos(\theta)}{\pi}$$

(3)

Ky parim mund të përdoret lehtësisht për të mbuluar dy ose më shumë ndryshime në vendosjen e fuqisë motorike, kur përqindja e energjisë nga θ_{m1} deri θ_{m2} është e barabartë me $F(\theta_{m2}) - F(\theta_{m1})$.

Efekti i ndryshimeve në vendosjen e fuqisë në maksimalen e L_{Amax} është llogaritur në bazë të formulës 4. Vlera më e lartë e dy alternativave në formulën 4 do të përdoret.

$$L_{Amax}(d) = L_{Amax,1}(d)$$

$$L_{Amax}(d) = L_{Amax,2}(d) = + 10 \log(\sin^4(\theta_m))$$

(4)

Ku:

$L_{Amax,1}(d)$ është niveli maksimal i fuqisë në distancën d, përkatësisht në segmentin që përmban P.

$L_{Amax,2}(d)$ është niveli maksimal i fuqisë në distancën d, që korrespondon me segmentit fqinj.

Gjithashtu, në rastin e niveleve maksimale, ky parim mund të përdoret lehtësisht për të mbuluar dy ose më shumë ndryshime në fuqinë e motorit, si alternativë e dytë e formulës 4 e përsëritur për çdo vendosje të fuqisë.

2.2. Llogaritja e nivelit të ekspozimit të tingullit me korrigjim për gjeometrinë e trajektore

2.2.1 Nevoja për korrigjime

Në praktikë, trajektorët e fluturimit nuk do të jenë gjithmonë të drejta, por do të përfshijnë, gjithashtu, kthesat. Për përshkruesin e zhurmë SEL, duke supozuar një flypast të drejtë, në përgjithësi nuk do të jetë e mjaftueshme për të marrë parasysh vetëm kontributin nga segmenti më i afërt. Normalisht do të jetë i pranueshëm thjeshtësimi afër me një trajektore të tillë. Megjithatë, në disa sektorë brenda rrjetit llogaritës, gabime të rëndësishme do të ndodhin. Për shembull, vlerësimi i SEL do të jetë shumë i ulët brenda kthesës, ndërsa ajo do të jetë shumë e lartë jashtë kthesës.

Dështimi, duke marrë në konsideratë kontributet e energjisë të tingullit jo ato të segmentit më të afërt të rrugës së fluturimit, është, gjithashtu, i detyruar të rezultojë në ndërprerje të rënda, në sektorë, ku dy pjesët e trajektorës janë pothuajse në mënyrë të barabartë në afërsi të pikave të llogaritjes. Ky efekt do të zmadhohet, nëse parametrat e fuqisë së përdorur në këto dy segmente do të ishin në thelb të ndryshme.

Një procedurë llogaritjeje shumë e thjeshtë, por saktësisht e arsyeshme, që mbulon problemet e trajtuara më sipër, është dhënë më poshtë. Nëse segmentimit është përdorur (shih neni 2.1.1), kjo merr parasysh efektin e gjeometrisë së trajektorës.

2.2.2 Procedura e korigjimit

Procedura e llogaritjes mund të ndahet në tre hapa:

Hapi 1: SEL është llogaritur duke marrë në konsideratë kontributin nga segmenti më i afërt dhe duke supozuar një fluturim të drejtë, lartësi dhe fuqi të vazhdueshme.

Nëse pika e llogaritjes është e vendosur në anën e jashtme të kthesës, një korigjim (negativ) i dhënë në dB duhet shtuar.

Hapi 2: Nëse pika e llogaritjes është vendosur kudo brenda një rrethi të përcaktuar nga qendra dhe rrezja e një kthese, një korigjim (pozitiv) i dhënë në dB duhet shtuar.

Hapi 3: Në rastet kur ekziston një segment tjetër më i afërt, kontributi nga ky segment është marrë, gjithashtu, në konsideratë. Megjithatë, një distancë nga trajektorja është përdorur, e cila është e ndryshme nga ajo aktuale.

Shënim. Përveçse duke shtuar dy llojet e korigjimeve në sektorë të ndryshëm dhe duke marrë në konsideratë kontributin e një segmenti tjetër më të afërt, asnjë ndryshim i parimeve themelore nuk është futur.

Në seksionet në vijim janë dhënë më shumë detaje mbi hapat e ndryshëm në procedurën e llogaritjeve.

2.2.3 Kontributi nga segmenti më i afërt (hapi 1)

Është supozuar se trajektorja nominale është e përbërë nga pjesët e drejta dhe rrethore.

Janë hequr vija perpendikulare me trajektoren përmes pikës së llogaritjes dhe distanca më e shkurtër mes pikës së trajektorës dhe pikës së llogaritjes është zgjedhur për llogaritjen e SEL.

2.2.4 Korigjim në anën e jashtme e një të kthehet (hapi 1)

Në figurën 3, është treguar një trajektore, duke përfshirë një seksion të lakuar. Seksioni i lakuar është përcaktuar nga qendra (C), këndi i kthesës (Ψ) dhe rreze (r). Një korigjim është aplikuar në qoftë se pika e llogaritjes J (në anën e jashtme të kthesës) ndodhet brenda këndit Ψ . Një linjë përmes C dhe J ndan Ψ (e matur në radian) në nënkënde Ψ_1 dhe Ψ_2 .

Shënim. $\Psi = \Psi_1 + \Psi_2$

Distanca nga J deri te trajektorja është shënuar me JT, ndërsa distanca nga J deri në C është shënuar me JC.

Shënim. $JC = JT + r$

Korigjim është dhënë nga:

$$\Delta L_{AE} (\text{outer}) = 10 [\sin (\Psi / 2)] \log [1-2,75 (JT / JC) \Psi_1 \cdot \Psi_2 / \Psi_2]$$

(5)

Shënim. $\Delta L_{AE} (\text{outer})$ është negative ose zero. $\Delta L_{AE} (\text{outer})$ bëhet zero në rastet e mëposhtme:

$JT = 0$ (nuk ka distancë nga kthesa)

$\Psi = 0$ (nuk ekzistojnë kthesa)


$\Psi_1 = 0$ ose $\Psi_2 = 0$.

Me rritjen e distancës drejt trajektorës, JT / JC do të takohet dhe një korigjim konstant në varësi të Ψ , Ψ_1 dhe Ψ_2 , do të zbatohet. Nëse Ψ_1 me Ψ_2 janë të barabartë, korigjimi do të jetë në kufirin -3,5dB për një kthesë 90 ° dhe -5dB për një kthesë 180 °.

Shënim. Nëse Ψ tejkalon 180° , korrighimi do të ulet përsëri.

Në mënyrë që të minimizojnë kohën e kompjuterit, kthesa të vogla mund të shpërfillen. Një korrighim limit prej -1 dB do të korrespondojë me një kthesë prej rreth 23° , kurse një korrighim limit prej -2 dB do të korrespondojë me një kthesë prej rreth 47° .

Figura 3 - llogaritja e SEL, hapi 1.



2.2.5 Korrighimi në anën e brendshme të një kthesë, brenda një rrethi të përcaktuar nga kthesa (hapi 2).

Në figurën 4, është treguar përsëri figura 3, por këtë herë me harkun e plotë të përcaktuar nga trajektorja e treguar. Një korrighim është aplikuar në ato pika llogaritje, të cilat janë të vendosura brenda rrethit, pra në qoftë se $JC < r$, ku r është rrezja e kthesës dhe JC është distanca nga pika e llogaritjes në qendër të kthesës. Korrighimi është dhënë nga:

$$\Delta L_{AE} (\text{inner}) = 10 \log \{1 (\Psi / \pi) [(r - JC) / r]^2\}$$

(6)

Shënim. $L_{AE} (\text{inner})$ është zero ose pozitive. $\Delta L_{AE} (\text{inner})$ është e barabartë me zero në rastet e mëposhtme:

$JC = r$ (nuk ka distancë nga trajektorja rrethore)

$\Psi = 0$ (nuk ekziston kthesë)

Në qendër të kthesës, një korrighim prej $+2$ dB do të aplikohet për një kthesë 90° dhe një korrighim prej $+3$ dB për një kthesë 180° . Në mënyrë që të minimizojnë kohën e kompjuterit, kthesat e vogla sërish mund të shpërfillen. Një korrighim limit prej $+1$ dB do të korrespondojë me një kthesë prej rreth 45° .

Shënim. Ekziston mundësia që J të jetë vendosur brenda më shumë se një rrethi. Në qoftë se ndodh ky rast, korrighimi më i madh do të përdoret në këtë hap.

2.2.6 Kontributi nga një segment tjetër më i afërt (hapi 3)

Në figurën 5, trajektorja nga figura 3 është treguar përsëri. Në këtë pjesë, pas qendrës së kthesës, ekziston një segment tjetër më i afërt. Vijat perpendikulare nga pika e llogaritjes J ndërpresin trajektoren në pikat A dhe B . Distanca për te trajektorja është shënuar si AJ (më e afërta) dhe JB (tjetra më e afërt).

Në vend të përdorimit të distancës tjetër më të afërt aktuale (JB) drejt trajektores, në mënyrë që të llogaritim SEL nga seksioni tjetër më afërt, një distancë (e madhe) korrighimi $J'B$ duhet përdorur, si më poshtë:

- Distanca e matur nëpërmjet J nga A në B, AJB, është $AJ + JB$.
- Distanca e matur nëpërmjet trajektorës nga A në B, ATB, është i matur duke marrë parasysh vetëm gjatësinë e seksioneve të drejta.

Në figurën 5, kthesa fillon në pikën E dhe mbaron në pikën F. Në këtë rast, kur ka vetëm një kthesë në mes A dhe B, ATB është $AE + FB$. Atëherë, distanca tjetër më e afërt e korrigjuar është dhënë si më poshtë:

$$J'B = JB / \sin [\arctan 4(ATB / AJB)]$$

(7)

Duke përdorur J'B si distancë tjetër më të afërt nga trajektorja, është llogaritur distanca e tatëpjetë dhe është llogaritur SEL për seksion tjetër më të afërt, siç përshkruhet në hapi 1.

Së fundmi, SEL-i total në J është llogaritur duke i shtuar përbërësit e seksioneve të trajektorës më të afërt dhe tjetër më të afërt.

J'B do të jetë gjithmonë më e madhe se JB. Nëse J është mjaft afër C, J'B do të jetë shumë më e madhe sesa JB dhe kontributi nga seksioni tjetër më i afërt do të jetë i parëndësishëm.

Megjithatë, tashmë në këtë rast një korrigjim është futur nga hapi 2 i procedurës llogaritëse.

Në mënyrë që të minimizojmë kohën e kompjuterit, edhe një herë kthesat e vogla do të shpërfillen. Megjithatë, në këtë rast nuk mund të jepen rregulla të përgjithshme, siç ishte rasti te hapi 1 dhe hapi 2. Duke supozuar lartësi të vazhdueshme dhe mosndryshime të fuqisë, dhe duke mos marrë parasysh absorvimin e tokës, kontributi nga seksioni tjetër më i afërt do të rritë SEL me më pak se 1 dB, nëse $JB > 2JA$, i pavarur nga shtrirja e kthesës. Nëse kthesa është më e vogël se rreth 17° , korrigjimi do të jetë më pak se 1 dB, i pavarur nga raporti midis JB dhe JA.

Figura 4 - llogaritja SEL, hapi 2.





Figura 5 - Ilogaritja SEL, hapi 3.



3. Metodatat e matjes së përkohshme për L_{den} dhe L_{night}

Metoda e matjes së përkohshme për L_{den} dhe L_{night} do të përcaktohet në bazë të përcaktimit të treguesit dhe parimit të përcaktuar në ISO 1996-2: 1987 dhe ISO 1996-1: 1982.

Të dhënat e matjeve para një fasade ose në një tjetër element të pasqyruar duhet të korrigjohen për të përjashtuar kontributin e reflektuar të kësaj fasade ose elementi (si rregull i përgjithshëm, kjo nënkupton një korrigjim 3 dB në rast të matjes).

4. Metodatat e matjes së përkohshme për L_{dpm} dhe L_{nate}

Metoda e matjes së përkohshme për L_{dpm} dhe L_{nate} do të përcaktohet në bazë të përcaktimit të treguesit dhe parimit të përcaktuar në ISO 1996-2: 1987 dhe ISO 1996-1: 1982.

Të dhënat e matjeve para një fasade ose në një tjetër element të pasqyruar duhet të korrigjohen për të përjashtuar kontributin e reflektuar të kësaj fasade ose elementi (si rregull i përgjithshëm, kjo nënkupton një korrigjim 3 dB në rast të matjes).

ANEKSI III METODAT PËR VLERËSIMIN E EFEKTEVE TË DËMSHME të referuara në nenin 6 (3)

Marrëdhëniet dozë-efekt duhet të përdoren për të vlerësuar efektin e zhurmës te popullata. Marrëdhëniet dozë-efekt, që mund të rezultojnë nga revizionime të ardhshme, në mënyrë të veçantë do të kenë të bëjnë me:

- lidhjen midis shqetësimit dhe L_{dpm} për zhurmën e rrugës, hekurudhave, trafikut ajror dhe zhurmat industriale;
- lidhjen midis shqetësimit gjatë gjumit dhe L_{nate} për zhurmat e rrugës, hekurudhave, trafikut ajror dhe zhurmat industriale.

Nëse është e nevojshme, marrëdhënie të veçanta dozë-efekt mund të paraqiten për:

- banesa me izolim nga zhurma të veçanta;
- banesa me një fasadë të qetë;
- klima të ndryshme / kultura të ndryshme;

- grupet e cënueshme të popullsisë;
- zhurmat e pandërprera industriale;
- zhurmat e ndërprera industriale dhe raste të tjera të veçanta.

ANEKSI IV
KËRKESAT MINIMALE PËR HARTËN STRATEGJIKE TË ZHURMAVE
të referuara në nenin 7

1. Një hartë strategjike e zhurmave është paraqitja e të dhënave në një nga aspektet e mëposhtme:

- një situatë zhurme ekzistuese, e mëparshme ose e parashikuar në termat e treguesit të zhurmës;

- tejkalimi i një vlere limit;
- numri i vlerësuar i banesave, shkollave dhe spitaleve në zonat e caktuara që janë të ekspozuara ndaj vlerave të veçanta të treguesit të zhurmës;

- numri i vlerësuar nga njerëzit e vendosur në një zonë të ekspozuar ndaj zhurmës.

2. Hartat strategjike të zhurmave mund të paraqiten për publikun, si:

- paraqitje grafike;
- të dhëna numerike në tabela;
- të dhëna numerike në formë elektronike.

3. Hartat strategjike të zhurmave për bashkësitë e popullsisë do të vënë një theks të veçantë në zhurmën e emetuar nga:

- trafiku rrugor;
- trafiku hekurudhor;
- aeroportet;
- zonat me aktivitet industrial duke përfshirë edhe portet.

4. Harta strategjike e zhurmave do të përdoret për qëllimet e mëposhtme:

- burim i informatave për qytetarët në pajtim me nenin 9;
- një bazë për planet e veprimt në pajtim me nenin 8.

5. Secili prej këtyre përdorimeve kërkon një lloj të ndryshëm të hartës strategjike të zhurmave.

6. Për qëllime të informimit të qytetarëve në pajtim me nenin 9 dhe zhvillimin e planeve të veprimt në pajtim me nenin 8, duhet të jepen të dhëna shtesë dhe më të detajuara, të tilla si:

- një prezantim grafik;
- harta që tregojnë tejkalimin e një vlere limit;
- ndryshimi në harta, në të cilat gjendja ekzistuese është e krahasuar me situatat e ndryshme të mundshme të ardhshme;

- treguesi i hartës për vlerën e treguesit të zhurmës në një lartësi tjetër përveç asaj 4 m, kur është e përshtatshme.

7. Hartat strategjike të zhurmave për aplikim kombëtar duhet të bëhen në një lartësi vlerësimi prej 4 m dhe rangun 5 dB të L_{dpm} dhe L_{nate} .

8. Për bashkësitë e popullatave duhet të bëhen harta strategjike të zhurmave të veçanta për zhurmat e trafikut rrugor, trafikut hekurudhor, zhurmat e aeroplanëve dhe zhurmat industriale. Mund të shtohen harta edhe për burime të tjera të zhurmave.

ANEKSI V
KËRKESAT MINIMALE PËR PLANET E VEPRIMIT
të referuara në nenin 8

1. Një plan veprimi duhet të paktën të përfshijë elementet në vijim:
 - një përshkrim të bashkësive të popullsisë, rrugëve kryesore, hekurudhave të mëdha ose aeroporteve të mëdha dhe burimeve të tjera të zhurmave të marra në konsideratë;
 - autoritetin përgjegjës;
 - kontekstin ligjor;
 - çdo vlerë kufitare në fuqi në përputhje me nenin 5;
 - një përmbledhje të rezultateve të hartës së zhurmave;
 - një vlerësim të numrit të përafërt të njerëzve të ekspozuar ndaj zhurmës, identifikimin e problemeve dhe të situatave që duhet të përmirësohen;
 - masa për reduktimin e zhurmave tashmë në fuqi dhe çdo projekt në përgatitje e sipër;
 - veprime, të cilat autoritetet kompetente kanë qëllim të marrin në pesë vitet e ardhshme, duke përfshirë edhe masat për të ruajtur zonat e qeta;
 - strategji afatgjatë;
 - informacion financiar (nëse ka): buxhetet, vlerësim i kosto-efektivitetit dhe kosto-përfitimit;
 - dispozitat e parashikuara për vlerësimin e zbatimit dhe rezultatet e planit të veprimit.
2. Autoritetet kompetente brenda kompetencave të tyre ndërmarrin masat, të cilat mund të përfshijnë:
 - planifikimin e trafikut;
 - planifikimin e përdorimit të tokës;
 - masat teknike në burimet e zhurmës;
 - përzgjedhjen e burimeve më të qeta;
 - reduktimin e transmetimit të zërit;
 - masa rregullatore ose masa ekonomike, ose stimuj.
3. Çdo planveprimi duhet të përmbajë vlerësime në lidhje me reduktimin e numrit të njerëzve të prekur (të bezdisur, me gjumë të paqetë apo të tjera).

UDHËZIM
Nr.9, datë 26.4.2011

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 5, DATË 30.1.2006
“PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR, LIDHUR ME DEKLARATËN
INDIVIDUALE VJETORE TË TË ARDHURAVE

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 10 343, datë 28.10.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.5, datë 30.1.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, pika 2.8 “Detyrimi i individëve për të deklaruar”, ndryshohet sa më poshtë:

“2.8 Detyrimi për dorëzimin e deklaratës individuale vjetore të të ardhurave dhe atyre që përjashtohen nga ky detyrim përcaktohet në nenin 13 “Deklarata individuale vjetore e të ardhurave” të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

Janë të përjashtuar nga detyrimi për plotësimin e deklaratës vjetore të të ardhurave të gjithë ata tatimpagues që përcakton pika 2 e nenit 13 të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

Çdo deklaratë vjetore e të ardhurave plotësohet me numrin e identifikimit personal të letërnjoftimit të individit.

2.8.1 Deklarata individuale vjetore e të ardhurave plotësohet nga:

a) individët rezidentë shqiptarë për të ardhurat e realizuara brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;

b) individët rezidentë të huaj për të ardhurat e realizuara në territorin e Republikës së Shqipërisë;

c) individët jorezidentë shqiptarë apo të huaj, sipas përcaktimit të pikës 3 të nenit 13 “Deklarata individuale vjetore e të ardhurave”, të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar mund të plotësojnë deklaratën vjetore të të ardhurave megjithëse nuk kanë detyrim ligjor për këtë. Individët jorezidentë, sipas përcaktimit të bërë në pikën 2 të nenit 7 të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, të cilët kanë detyrimin për pagesën e tatimit mbi të ardhurat personale të realizuara në territorin e Republikës së Shqipërisë;

d) të vetëpunësuarit rezidentë, vendas ose të huaj, të cilët realizojnë të ardhura nga veprimtaria e biznesit të vogël, krahas deklaratës për biznesin e ushtruar e cila duhet dorëzuar deri në datën 31 mars të vitit pasardhës, duhet të plotësojnë për pjesën e fitimit pas tatimit (të përfutur në formën e të ardhurave personale) edhe deklaratën individuale vjetore të të ardhurave sikurse dhe individët e tjerë jo më vonë se data 30 prill e vitit që pason periudhën tatimore për të cilën bëhet deklarimi;

Deklarata individuale vjetore e të ardhurave mund të plotësohet edhe nga persona të tjerë të cilët vendosin të bëjnë deklaratën, megjithëse nuk kanë detyrim ligjor të bëjnë këtë deklarim, si dhe nga ata të përcaktuar në pikën 2 të nenit 13 të ligjit, të cilët duan të përfitojnë nga skema e shpenzimeve të zbritshme, të parashikuara në këtë ligj.

Bashkëngjitur këtij udhëzimi janë “Deklarata individuale vjetore e të ardhurave”, të individëve shqiptarë, “Deklarata individuale vjetore e të ardhurave”, të individëve të huaj dhe formulari i pagesës së tatimit mbi të ardhurat individuale vjetore sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 13/7 të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar. Deklaratat shoqërohen me udhëzuesit për plotësimin e çdo rubrike të saj nga individi deklarues.

Deklarata individuale vjetore e të ardhurave dorëzohet në Drejtorinë Rajonale Tatimore, e cila mbulon vendbanimin e individit deklarues, dorazi, me postë apo në rrugë elektronike jo më vonë se data 30 prill që pason periudhën tatimore, për të cilën bëhet deklarimi. Detyrimi i parë i deklarimit bëhet brenda datës 30 prill 2012 për vitin fiskal 2011.

Nëse nga plotësimi i deklaratës rezulton se individi deklarues duhet të paguajë tatim, bazuar në rubrikën “Totali për t’u paguar të deklaratës individuale vjetore të të ardhurave”, individi plotëson formularin “Dokument i pagesës së tatimit mbi të ardhurat individuale”, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së deklaratës vjetore të të ardhurave, bën pagesën e tatimit në bankë.

Në rast të plotësimit të gabuar të deklaratës, kjo e fundit mund të korrigjohet nga individi duke plotësuar një deklaratë të re, duke vendosur shenjën “X” në kutinë përkatëse, brenda tre muajve nga data e dorëzimit të deklaratës së parë.

Për mosdeklarimin në afat të deklaratës individuale vjetore të të ardhurave, zbatohen sanksionet administrative të përcaktuara në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Për efekt të plotësimit të deklaratës, nuk përfshihen në të ardhurat bruto, të ardhurat e përcaktuara në nenin 8/1 të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

Kryefamiljari plotëson deklaratën vjetore individuale të të ardhurave, në të cilat përfshin edhe personat nën kujdestari të cilët nuk krijojnë të ardhura.

Individët brenda familjes që kanë të ardhura nga burime të ndryshme, me përjashtim të të ardhurave të përcaktuara në nenin 8/1 të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, janë të detyruar të deklarojnë individualisht. Në rastin kur individi brenda familjes nuk ka aftësi për të plotësuar deklaratën, kjo e fundit plotësohet nga kryefamiljari ose personi që e ka nën kujdestari dhe nënshkruhet nga të dy.

Shembull. Një familje është e përbërë nga kryefamiljari, bashkëshortja dhe 3 fëmijët. Kryefamiljari ka realizuar të ardhura individuale vjetore gjithsej për 700 000 lekë, bashkëshortja ka realizuar të ardhura individuale vjetore gjithsej për 600 000 lekë, ndërsa fëmijët nuk kanë të ardhura individuale.

Në zbatim të nenit 13 të ligjit, detyrimin për dorëzimin e deklaratës individuale vjetore të të ardhurave e ka kryefamiljari dhe gruaja në deklaratë të veçanta, sipas modelit të miratuar, duke plotësuar rubrikat respektive të deklaratës individuale vjetore të të ardhurave.

Meqenëse kryefamiljari për periudhën tatimore ka realizuar të ardhura individuale vjetore 700 000 lekë (pra më pak se kufiri 800 000 lekë), ka të drejtën të përfitojë nga njohja e shpenzimeve të zbritshme të përcaktuara në nenin 13/3 të ligjit dhe në rubrikën 19 (shuma e shpenzimeve të zbritshme) të deklaratës individuale vjetore të të ardhurave.

Për fëmijët, meqenëse nuk kanë realizuar të ardhura (sipas shembullit), ata duhet të deklarohen në deklaratën e kryefamiljarit dhe atë të gruas duke plotësuar kutitë përkatëse në rubrikën 17 “Persona në kujdestari të deklaruesit” të seksionit A të deklaratës individuale vjetore të të ardhurave me të njëjtën numër 3 (tre).

Nëse fëmijët realizojnë të ardhura individuale gjatë periudhës tatimore, ato duhet të deklarojnë individualisht këto të ardhura nëpërmjet plotësimit të deklaratës. Në pamundësi për plotësimin nga ana e tyre, deklaratën e plotëson njëri prej anëtarëve të familjes.

Nëse kryefamiljari realizon të ardhura vjetore mbi kufirin 800 000 lekë, ai nuk do të përfitonte nga shpenzimet e zbritshme të përcaktuara në nenin 13/3 të ligjit.

Personat jorezidentë, në zbatim të pikës 1 të nenit 13/3 të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, nuk përfitojnë nga e drejta e llogaritjes së shpenzimeve të zbritshme.

Të punësuarit në institucione buxhetore dhe jobuxhetore, të cilët, përveç të ardhurave me burim nga punësimi, realizojnë edhe të ardhura nga burime të tjera, duhet të plotësojnë këtë deklaratë.

2.8.2. Deklaruesit, të cilët zgjedhin dorëzimin e deklarimit dorazi ose në rrugë postare, mund të tërheqin kopje të formularit të deklarimit të të ardhurave individuale vjetore pranë:

- a) drejtorive rajonale tatimore (zyrat e shërbimit ndaj tatimpaguesve);
- b) zyrave postare.

2.8.3. Për çdo të ardhur dhe shpenzim, të referuar në deklaratën individuale vjetore të të ardhurave, individi deklarues që plotëson deklaratën duhet t’i paraqesë organit tatimor me kërkesën e këtij të fundit dokumentacionin, si më poshtë:

a) për të ardhura bruto nga paga apo shpërblimet nga marrëdhëniet e punësimit, vërtetim nga punëdhënësi mbi të ardhurat vjetore dhe tatimet e mbajtura mbi pagën;

b) për fitimin nga zhvillimi i veprimtarisë së biznesit të vogël, që rezulton nga deklaratë e të ardhurave personale të biznesit të vogël për të vetëpunësuarit, kopje të deklaratës vjetore tatimore, sipas nenit 12/6 të ligjit për tatimin mbi të ardhurat dhe mandatpagesës së tatimit mbi të ardhurat personale;

c) për të ardhurat bruto nga dividendi për pjesëmarrje në shoqëri tregtare apo nga veprimtaritë e biznesit, kopje të vendimit të Asamblesë së Ortakëve për miratimin e rezultatit financiar dhe destinimin e fitimit, ku specifikohet dividendi i shpërndarë dhe kopje të mandatpagesës së bërë të tatimit mbi dividendin nga personi juridik;

d) për të ardhurat bruto nga qiraja dhe fitimet kapitale nga shitja e pasurisë së paluajtshme, në pronësi të deklaruesit, kopje të kontratës së qirasë/shitjes dhe të dokumentit që vërteton pagesën e tatimit mbi të ardhurat;

e) për të ardhurat bruto nga interesa bankarë, dokumentin bankar që vërteton këto të ardhura;

f) për fitimin kapital neto, të krijuar nga investimet në tituj apo në pasuri të paluajtshme, kopje të kontratës së investimit dhe mandatpagesës së tatimit;

g) për shumat bruto të fituara nga lotari apo lojëra të tjera të fatit, kopje të vërtetimit të organizatorit të lojës për fitimin e shumës së fituar të parave dhe kopje të mandatpagesës nga organizatori të tatimit në burim si diferencë midis shumës së fituar dhe shumës së luajtur nga lojtari;

h) për të ardhurat bruto nga pasuria intelektuale, licencat, të drejtat ekskluzive dhe pasuri të tjera, që përbëhen vetëm nga të drejta dhe që nuk kanë formë fizike, kopje të licencave/lejeve dhe mandatpagesës të tatimit në burim;

i) për fitimin kapital nga dhurimi, kopje të dokumenteve vërtetuese për justifikimin e origjinës së të ardhurave dhe mandatpagesës së tatimit të paguar;

j) të ardhura bruto të realizuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, çdo dokument vërtetues për justifikimin e origjinës së të ardhurave dhe tatimit të paguar;

k) për të ardhura bruto të tjera të papërmendura më lart, çdo dokument që justifikon realizimin e të ardhurave.

2.8.4. Dokumentet që duhet t'i bashkëngjiten deklaratës, për justifikimin e shpenzimeve të zbritshme, janë si më poshtë:

a) për pjesën e shpenzimeve për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe kontributet vullnetare të pensioneve, sipas përcaktimeve në ligjin për fondet e pensionit vullnetar, kopje të kontratës së fondit të pensionit me shoqërinë administruese dhe kopje të pagesave të bëra;

b) për shumat e interesit bankar të kredisë së marrë për shkollim, për vete apo për fëmijët dhe personat në kujdestari, kopje të kontratës me bankën brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, ku të jetë e specifikuar se kredia e marrë është për shkollim, si dhe kopje të mandatpagesave të interesave bankarë të paguar gjatë vitit;

c) për justifikimin e shpenzimeve të zbritshme për mjekim, për vete apo për fëmijët dhe personat në kujdestari, për pjesën e pambuluar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor, kopje të faturave dhe të mandatpagesave të bëra për mjekim në institucionet shëndetësore deri në shumën e përcaktuar sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.94, datë 9.2.2011. Në rastin e plotësimit të deklaratës nga kryefamiljari ose bashkëshortja, deklaratës i bashkëlidhet kopja e certifikatës familjare, lëshuar nga zyrat e gjendjes civile, në vitin e plotësimit të deklaratës.

Në rast të plotësimit të deklaratës nga individ (jokryefamiljar), shpenzimet vjetore për mjekim, për pjesën e pambuluar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor janë 8,532 lekë.

Në rast të plotësimit të deklaratës nga kryefamiljari, bazuar në pikën 3 të nenit 13/1 të ligjit për tatimin mbi të ardhurat, shpenzimet vjetore për mjekim, për vete apo për fëmijët dhe personat në kujdestari, për pjesën e pambuluar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor janë 8,532 lekë për secilin anëtar të familjes, por jo më shumë se 32,000 lekë.

Nëse nga plotësimi i deklaratës individuale vjetore e të ardhurave rezulton diferencë negative, pra individ deklaruës ka derdhur më shumë tatime nga sa rezulton nga llogaritja sipas deklaratës, administrata tatimore (drejtoria rajonale tatimore) duhet t'i kthejë individit deklaruës shumën e tatimeve të paguara me tepër me kërkesën e tij. Me kërkesën me shkrim të deklaruësit, kjo shumë mund të kalohet për llogari të detyrimeve tatimore të ardhshme për vitin tatimor vijues.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode



**DOKUMENTI I PAGESËS SË TATIMIT
MBI TË ARDHURAT INDIVIDUALE**

Numri i Vendosjes së Dokumentit (NVD)
(Vetëm për përdorim zyrtar)

(1) Numri Serial: _____

(2) Periudha tatimore

(3) Numri i Identifikimit Personal / Numri Fiskal i Individit

(4) Emri _____, Atësia _____, Mbiemri _____

(5) Adresa kryesore: _____

(6) Qyteti/Komuna/Rrethi: _____

(7) Totali i Detyrimit për të paguar:

[7]

LLOGARITË

(8) NUMRI I LLOGARISË SË ORGANEVE TATIMORE: _____

(9) NUMRI I LLOGARISË SË INDIVIDIT: _____

Emri Mbiemri _____

Firma _____ Data ____/____/____

PAGESA

MENVRA E PAGESËS

(Vetëm për përdorim zyrtar)

- Lekë
 Xhirim
 Çek
 Të tjera:.....

SHUMA E PAGUAR:

[10]

Data e pagesës: _____

Vula e Bankës dhe nënshkrimi i nëpunësit të bankës

Originali - Zyra e Tatimeve
Kopja - Personi i Tatueshem

UDHËZUES
PËR MËNYRËN E PLOTËSIMIT TË DOKUMENTIT TË PAGESËS SË TATIMIT
MBI TË ARDHURAT INDIVIDUALE

1. **Numri serial** - përdoret nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe shërben për të azhurnuar regjistrimet tuaja kur paraqitet ky dokument.

2. **Periodha tatimore** - është periodha që përfshin pagesën nga data 1 janar deri 31 dhjetor.

3. **Numri i identifikimit personal/numri fiskal i individit** - plotësohet sipas numrit që deklaruesi ka në dokumentin e letërnjoftim ID (në kartën e identitetit) dhe për individët e huaj sipas numrit fiskal të dhënë nga organet tatimore shqiptare.

4. **Emri, atësia, mbiemri** - plotësohet sipas të dhënave të individit.

5. **Adresa kryesore** plotësohet për adresën që deklaruesi ka sipas të dhënave në regjistrin e gjendjes civile ose të ndryshuar. Për individin e huaj do të vendoset adresa në Republikën e Shqipërisë e dhënë në deklaratën e të ardhurave individuale vjetore.

6. **Qyteti/komuna/rrethi** - plotësohet sipas adresës së vënë në regjistrin e gjendjes civile ose të ndryshuar. Për individët e huaj plotësohet sipas vendbanimit në Republikën e Shqipërisë.

7. **Totali i tatimit për t'u paguar**- plotësohet për shumën e tatimit që individi duhet të paguajë bazuar në rubrikën "Totali për t'u paguar të deklaratës individuale vjetore të të ardhurave".

LLOGARITË

8. **Numri i llogarisë bankare në organet tatimore** - plotësohet me numrin e llogarisë bankare që kanë organet tatimore në bankën ku kryhet pagesa.

9. **Numri i llogarisë së individit** - plotësohet me numrin e llogarisë bankare që individi ka në bankën, ku kryen pagesën e tatimit mbi të ardhurat individuale vjetore.

Vendosni emrin, mbiemrin dhe datën e pagesës së tatimit, firmoseni atë dhe paraqiteni në bankë, ku një kopje e këtij dokumenti do t'ju kthehet nga nëpunësi i bankës pas pagesës.

PAGESA

Kjo pjesë e dokumentit plotësohet nga banka në të cilin individi do të kryejë pagesën e tatimit mbi të ardhurat individuale vjetore.



**DEKLARATA INDIVIDUALE
VJETORE E TË ARDHURAVE
PËR INDIVIDËT E HUAJ**

Numri i Vendosijes së Dokumentit (NVD)
(Vetëm për përdorim zyrtar)

(2) Periudha tatimore (viti)

(1) Numri Serial:

Vendos 'X' në kutinë e duhur nëse nuk po dorëzon për herë të parë për këtë periudhë të dorëzimit KORRIGJUESE

SEKSIONI A : TË DHËNA IDENTIFIKUESE

[3] REZIDENT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

[4] JOREZIDENT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

[5] Numri fiskal i individit të huaj _____

TË DHËNA IDENTIFIKUESE PËR INDIVIDIN

[6] Emri _____, Atësia _____; Mbiemri _____, Seksi: M F

[7] Numri i identifikimit personal sipas pasaportës të deklaruesit _____

[8] Telefoni: _____; Celular: _____; E_mail: _____

[9] Statusi i Deklaruesit I/E martuar I/E martuar me Beqar/e I/E ve I/E divorcuar Kryefamiljar/e
 fëmijë

TË DHËNA PËR BANIMIN E INDIVIDIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

[10] Adresa: _____; Emri i pronarit _____

[11] Qyteti/Komuna/Rrethi: _____

[12] Të dhëna mbi pronësinë e banesës kryesore: a) Në pronësi b) Me qira c) Falas nga pronari d) Të tjera

[13] Qëndrimi në hotel(Adresa e hotelit): _____

TË DHËNA PËR ADRESËN E BANIMIT TË INDIVIDIT NËSE KA NDRYSHIME

[14] Adresa: _____; Emri i pronarit: _____

[15] Qyteti/Komuna/Rrethi: _____

[16] Të dhëna mbi pronësinë e banesës: a) Në pronësi b) Me qira c) Falas nga pronari d) Të tjera

[17] Qëndrimi në hotel(Adresa e hotelit): _____

TË DHËNA PËR BANIMIN E INDIVIDIT NË VENDIN E HUAJ

[18] Adresa: _____

[19] Qyteti/Komuna: _____

[20] Shteti: _____

[21] Nr. Tel: _____; Cel: _____; E_mail: _____

[22] Persona nën kujdestarinë e deklaruesit gjithsej Numri i personave në kujdestari Të tjerë persona në kujdestari

Personi Deklarues
(Emri/Mbiemri) _____

Data e deklarimit ____/____/____

Firma _____

(1) Numri Serial: _____

NVD: _____

(2) Periudha tatimore (viti) _____

SEKSIONI B : TË DHËNA PËR LLOGARITJEN E TATIMIT

TË ARDHURAT BRUTO

[3]	Të ardhurat bruto nga paga apo shpërblime nga marrëdhëniet e punësimit për individët.....	[3]	
[4]	Fitimi nga zhvillimi i veprimtarisë së Biznesit të Vogël.....	[4]	
[5]	Të ardhurat bruto nga dividendat	[5]	
[6]	Të ardhurat bruto nga qiraja.....	[6]	
[7]	Fitime kapitale nga shitja e pasurisë së paluajtshme në pronësi të deklaruesit.....	[7]	
[8]	Të ardhurat bruto nga interesat bankare.....	[8]	
[9]	Fitimi kapital i krijuar nga investimet në tituj apo nga pasuri të paluajtshme.....	[9]	
[10]	Shuma bruto të fituara nga lotari apo lojra të tjera të fatit.....	[10]	
[11]	Të ardhurat bruto nga pasuria intelektuale licenca, të drejta ekskluzive dhe pasuri të tjera që përbehen vetëm nga të drejta dhe që nuk kanë formë fizike.....	[11]	
[12]	Fitime kapitali nga dhurimi.....	[12]	
[13]	Të ardhura bruto të realizuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.....	[13]	
[14]	Të ardhura bruto të tjera të papërmendura më lart	[14]	
[15]	SHUMA E TË ARDHURAVE BRUTO (nga 3 deri 14)		[15]

SHPENZIME TË ZBRITSHME

[16]	Kontributet vullnetare në fondin e pensionit vullnetar dhe kontributet vullnetare të individit për shëndetin.....	[16]	
[17]	Shuma e interesit bankar të kredisë së marrë për shkollim	[17]	
[18]	Shpenzimet për mjekim për vete apo për fëmijët dhe për personat në kujdestari për pjesën e pambuluar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor.....	[18]	
[19]	SHUMA E SHPENZIMEVE TË ZBRITSHME (kutia 16 deri 18)		[19]

TATIMI I LLOGARITUR PËR T'U PAGUAR

[20]	Të ardhura të tatueshme (kutia 15 – 19 kur 15>19).....	[20]	
[21]	Shpenzime të pambuluara nga të ardhurat (kutia 19 – 15 kur 15<19).....	[21]	
[22]	SHUMA E TATIMIT TË LLOGARITUR (Kutia 20 x10%)		[22]

TATIME TË PAGUAR GJATË PERIUDHËS TATIMORE

[23]	Tatimi mbi pagën	[23]	
[24]	Tatimi mbi interesat.....	[24]	
[25]	Tatimi mbi qiranë.....	[25]	
[26]	Tatimi mbi dividendin	[26]	
[27]	Tatimi mbi të ardhurat e tjera.....	[27]	
[28]	SHUMA E TATIMIT TË PAGUAR GJATË PERIUDHËS TATIMORE(kutia 23 deri 27)....		[28]
[29]	TATIMI I PAGUAR TEPËR NGA VITI I MËPARSHËM DHE I PARIMBURSUAR....	[29]	
[30]	TATIMI I PAGUAR TEPËR (për rimbursim).....	[30]	
[31]	TATIMI I DETYRUESHËM PËR T'U PAGUAR.....		[31]

Personi Deklarues

(Emri/Mbiemri) _____

Data e deklarimit ____/____/____

Firma _____

**UDHËZUES PËR MËNYRËN E PLOTËSIMIT TË DEKLARATËS INDIVIDUALE
VJETORE TË TË ARDHURAVE TË INDIVIDËVE TË HUAJ NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË**

1. Numri serial përdoret nga Drejtoria Rajonale Tatimore (organi tatimor) dhe shërben për të azhurnuar regjistrimet tuaja kur paraqitet deklarata.
2. Periudha tatimore është periudha që përfshin deklarimin nga data 1 janar deri në 31 dhjetor të vitit raportues.

SEKSIONI A : TE DHËNA IDENTIFIKUESE

3. Rezident në Republikën e Shqipërisë. Plotësohet duke vendosur shenjën "X" në kutinë nëse individ i huaj është rezident në Republikën e Shqipërisë.
4. Jo rezident në Republikën e Shqipërisë. Plotësohet duke vendosur shenjën "X" në kutinë nëse individ i huaj nuk është rezident në Republikën e Shqipërisë.
5. Numri fiskal i individit të huaj. Plotësohet nga organi tatimor me dorëzimin e deklaratës.
- Të dhëna identifikuese për individin.**
6. Emri, atësia, mbiemri, seksi. Plotësohet me të dhënat e individit i cili deklaron me anë të kësaj deklarate me germa kapitale.
7. Numri i identifikimit personal sipas pasaportës së deklaruesit plotësohet sipas numrit që deklaruesi ka në pasaportën e tij.
8. Telefon, celular, e-mail, plotësohet me numrin e telefonit, celularit dhe adresën e e-mailit, që disponon deklaruesi.
9. Statusi i deklaruesit, plotësohet duke vendosur shenjën "X" brenda kutive.

Të dhëna për banimin e individit në Republikën e Shqipërisë

10. Adresa plotësohet sipas adresës së banimit duke plotësuar edhe emrin e pronarit të banesës.
11. Qyteti/komuna/rrethi plotësohet sipas vendit ku banon deklaruesi në Republikën e Shqipërisë.
12. Të dhëna mbi pronësinë e banesës plotësohet duke vendosur shenjën "X" nëse banesa është në pronësi të deklaruesit me dokument hipoteke, marrë me qira, dhënë falas dhe të tjerë.
13. Qëndrimi në hotel (adresa e hotelit), plotësohet me adresën e hotelit tek i cili ka qëndruar individ.

Të dhëna për adresën e individit nëse ka ndryshime.

14. Adresa plotësohet sipas adresës së banimit duke plotësuar edhe emrin e pronarit të banesës.
15. Qyteti/komuna/rrethi plotësohet sipas vendit ku banon deklaruesi në Republikën e Shqipërisë.
16. Të dhëna mbi pronësinë e banesës plotësohet duke vendosur shenjën "X" nëse banesa është në pronësi të deklaruesit me dokument hipoteke, marrë me qira, dhënë falas dhe të tjerë.
17. Qëndrimi në hotel (adresa e hotelit) plotësohet me adresën e hotelit tek i cili ka qëndruar individ.

Të dhëna për banimin e individit në vendin e huaj

18. Adresa plotësohet sipas adresës së banimit të deklaruesit në vendin e huaj.
19. Qyteti/komuna plotësohet me të dhënat e qytetit dhe të komunës në vendin e huaj.
20. Shteti plotësohet me të dhënat e shtetit në të cilin banon individ i huaj.
21. Telefon, celular, e-mail, plotësohet me numrin e telefonit, celularit dhe adresën e e-mailit, që disponon deklaruesi.
22. Persona nën kujdestarinë e deklaruesit plotësohet nga kryefamiljari apo bashkëshortja kur kjo është kryefamiljare duke vënë në kuti, numrin e personave brenda familjes në kujdestari dhe numrin e të tjerë personave në kutinë tjetër.

**SEKSIONI B: TË DHËNA PËR LLOGARITJEN E TATIMIT
TË ARDHURAT BRUTO**

3. Të ardhurat bruto nga pagat apo shpërblimet nga marrëdhëniet e punësimit për individët, plotësohet për totalin e pagave dhe shpërblimeve që deklaruesi përfiton nga të gjitha marrëdhëniet e punësimit gjatë periudhës tatimore.
4. Fitimi nga zhvillimi i veprimtarisë së biznesit të vogël, plotësohet nga deklaruesi për shumën e fitimit të tatueshëm që deklaruesi i vetëpunësuar, realizon nga veprimtaria e biznesit të vogël me qarkullim mbi 2 000 000 lekë (kutia 18 e formularit të deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël)
5. Të ardhurat bruto nga dividendi për pjesëmarrje në shoqëritë tregtare apo nga veprimtaritë e biznesit, do të plotësohet për shumën e dividendit që deklaruesi përfiton nga të gjitha pjesëmarrjet e tij në shoqëritë tregtare, apo veprimtaritë e biznesit.
6. Të ardhurat bruto nga qiratë do të plotësohet për totalin e të ardhurave bruto që individit realizon nga dhëna me qira e një ose disa objekteve.
7. Fitimet kapitale nga shitja e pasurisë së paluajtshme në pronësi të deklaruesit, do të plotësohet për totalin e fitimeve të realizuara në zbatim të nenit 11, të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

8. Të ardhurat bruto nga interesat bankare, do të plotësohen për totalin e të ardhurave nga interesat bankarë që individ i ka përfituar, gjatë periudhës tatimore.
9. Fitimi kapital neto i krijuar nga investimet në tituj apo nga pasuri të paluajtshme, do të plotësohet për totalin e fitimeve të realizuara nga investimet në tituj, shitje aksionesh, e pasuri të paluajtshme, përveçse tokë e ndërtesë që janë pasqyruar në kutinë 7. Me termin "fitim kapital i realizuar" kuptohet diferenca ndërmjet vlerës në shitje dhe vlerës në blerje të pasurisë.
10. Shuma bruto të fituara nga lotari apo lojëra të tjera të fatit, do të plotësohet për totalin e shumave bruto të fituara nga lotaritë apo lojëra të tjera të fatit.
11. Të ardhura bruto nga pasuri intelektuale licenca, të drejta ekskluzive dhe pasuri të tjera që përbëhen vetëm nga të drejta dhe që nuk kanë formë fizike, do të plotësohet për totalin e të ardhurave bruto nga të gjitha, sa përshkruar më sipër.
12. Fitimet kapitale nga dhurimi do të plotësohet për shumën e fitimeve kapitale të realizuara nga dhurimi.
13. Të ardhurat bruto të realizuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, do të plotësohet për totalin e të ardhurave bruto të realizuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
14. Të ardhura bruto të tjera të papërmendura më lart, do të plotësohet për totalin e të ardhurave bruto të tjera të cilat nuk janë të përfshira në të ardhurat e sipërsënuara.
15. Shuma e të ardhurave bruto (3-14) plotësohet për totalin e të ardhurave nga kutia 3 deri në kutinë 14.

SHPENZIME TË ZBRITSHME

16. Kontributet vullnetare në fondin e pensionit vullnetar dhe kontributet vullnetare të individit për shëndetin plotësohet vetëm kur individ i ka derdhur kontribut për fondet e pensionit vullnetar në zbatim të ligjit "Për fondet e pensionit vullnetar" dhe kontributet vullnetare për shëndetin.
17. Shuma e interesit bankar të kredisë së marrë për shkollim për vete apo për fëmijët dhe personat në kujdestari, do të plotësohet për shumën e interesit bankar të kredisë së marrë për shkollim nga banka brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
18. Shpenzimet për mjekim për vete apo për fëmijët dhe personat në kujdestari për pjesën e pambuluar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor, do të plotësohet mbështetur në faturat e lëshuara nga institucionet shëndetësore brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, për justifikimin e shpenzimeve për mjekim, sipas përcaktimeve në aktet nënligjore.
19. Shuma e shpenzimeve të zbritshme, plotësohet për totalin e shpenzimeve nga kutia 16-18.

TATIMI I LLOGARITUR PËR T'U PAGUAR

20. Të ardhura të tatueshme plotësohet për diferencën ndërmjet shumës së të ardhurave bruto (kutia 15) me shumën e shpenzimeve të zbritshme (kutia 19), kur (15 > 19).
21. Shpenzimet të pambuluara nga të ardhurat plotësohet për diferencën kur shuma e shpenzimeve të zbritshme (kutia 19) është më e madhe se shuma e të ardhurave bruto (kutia 15).
22. Shuma e tatimit të llogaritur, plotësohet për shumën e tatimit të llogaritur që rezulton nga shumëzimi i të ardhurave të tatueshme (kutia 20) me përqindjen e tatimit mbi të ardhurat në masën 10%.

TATIME TE PAGUARA GJATE PERIUDHES TATIMORE

23. Tatimi mbi pagën plotësohet për shumën e tatimit mbi pagën dhe shpërblimet mbi pagën të paguar gjatë periudhës tatimore.
 24. Tatimi mbi interesat plotësohet për shumën e tatimit mbi interesat bankare të paguara gjatë periudhës tatimore.
 25. Tatimi mbi qiranë plotësohet për shumën e tatimit mbi qiranë të paguar gjatë periudhës tatimore.
 26. Tatimi mbi dividendin plotësohet për shumën e tatimit mbi dividendët të paguar gjatë periudhës tatimore.
 27. Tatimi mbi të ardhurat e tjera, plotësohet për shumën e tatimit mbi të ardhurat e tjera të paguara gjatë periudhës tatimore.
 28. Shuma e tatimit të paguar gjatë periudhës tatimore, plotësohet për shumën e tatimit të paguar nga kutia 23 deri në kutinë 27 të deklaratës.
 29. Tatimi i paguar tepër nga viti i mëparshëm dhe i parimbursuar, plotësohet për shumën e tatimit të paguar tepër nga viti i mëparshëm dhe që rezulton i parimbursuar deri në ditën e deklarimit.
 30. Tatimi i paguar tepër (për rimbursim) plotësohet për diferencën nëse tatimi i paguar gjatë periudhës tatimore (kutia 28) është më i madh se tatimi i llogaritur sipas deklaratës (kutia 22).
 31. Tatimi i detyrueshëm për t'u paguar (kutia 22 minus kutinë 28 minus kutinë 29) plotësohet për diferencën midis shumës së tatimit të llogaritur sipas deklaratës (kutia 22) minus shumën e tatimit të paguar (kutia 28) minus tatimin e paguar tepër nga viti i mëparshëm dhe i parimbursuar (kutia 29).
- Në fund të faqes së parë, të dytë dhe të tretë të vendoset emri, mbiemri, firma e deklaruesit dhe data e deklarimit.*



**DEKLARATA INDIVIDUALE
VJETORE E TË ARDHURAVE**

Numri i Vendosijes së Dokumentit (NVD)
(Vetëm për përdorim zyrtar)

(2) Periudha tatimore (viti) _____

(1) Numri Serial: _____

Vendos 'X' në kutinë e duhur nëse nuk po dorëzon për herë të parë për këtë periudhë të dorëzimit KORRIGJUESE

SEKSIONI A : TË DHËNA IDENTIFIKUESE

[3] REZIDENT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

[4] JOREZIDENT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

TË DHËNA IDENTIFIKUESE PËR INDIVIDIN

(5) Emri _____, Atësia _____; Mbiemri _____, Seksi: M F

(6) Numri i identifikimit personal sipas letërnjoftimit të deklaruesit _____

(7) Adresa kryesore: _____

(8) Qyteti/Komuna/Rrethi: _____

(9) Statusi i Deklaruesit I/E martuar I/E martuar me fëmijë Beqar/e I/E ve I/E divorcuar Kryefamiljar/e

TË DHËNA PLOTËSUESE PËR INDIVIDIN

(10) Telefoni _____, Cel. _____, E-mail _____

(11) Të dhëna mbi pronësinë e banesës kryesore: a) Në pronësi b) Me qira c) Falas nga pronari d) Te tjere

(12) Emër/Mbiemër i pronarit _____, Adresa _____

ADRESA E BANIMIT NËSE ËSHTË E NDRYSHME NGA ADRESA E TË DHËNAVE IDENTIFIKUESE

(13) Adresa _____

(14) Nr. Tel: _____, Cel _____, E-mail _____

(15) Të dhëna mbi pronësinë e banesës ku jeton: a) Në pronësi b) Me qira c) Falas nga pronari d) Të tjere

(16) Emri /Mbiemri i pronarit _____, Adresa _____

PERSONA NË KUJDESTARINË E DEKLARUESIT

(17) Persona nën kujdestarinë e deklaruesit gjithsej Numri i personave brenda familjes në kujdestari Të tjerë persona në kujdestari

Personi Deklarues
(Emri/Mbiemri) _____

Data e deklarimit ____/____/____

Firma _____

(1) Numri Serial: _____

NVD: _____

(2) Periudha tatimore (viti) _____

SEKSIONI B : TË DHËNA PËR LLOGARITJEN E TATIMIT

TË ARDHURAT BRUTO

[3]	Të ardhurat bruto nga paga apo shpërblime nga marrëdhëniet e punësimit për individët.....	[3]	
[4]	Fitimi nga zhvillimi i veprimtarisë së Biznesit të Vogël.....	[4]	
[5]	Të ardhurat bruto nga dividendi	[5]	
[6]	Të ardhurat bruto nga qiraja.....	[6]	
[7]	Fitime kapitale nga shitja e pasurisë së paluajtshme(tokë dhe ndërtesë) në pronësi të deklaruësit.....	[7]	
[8]	Të ardhurat bruto nga interesat bankare.....	[8]	
[9]	Fitimi kapital i krijuar nga investimet në tituj apo nga pasuri të paluajtshme.....	[9]	
[10]	Shuma bruto të fituara nga lotari apo lojra të tjera të fatit.....	[10]	
[11]	Të ardhurat bruto nga pasuria intelektuale liçensa, të drejta ekskluzive dhe pasuri të tjera që përbehen vetëm nga të drejta dhe që nuk kanë formë fizike.....	[11]	
[12]	Fitime kapitali nga dhurimi.....	[12]	
[13]	Të ardhura bruto të realizuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.....	[13]	
[14]	Të ardhura bruto të tjera të papërmendura më lart	[14]	
[15]	SHUMA E TË ARDHURAVE BRUTO (nga 3 deri 14)		[15]

SHPENZIME TË ZBRITSHME

[16]	Kontributet vullnetare në fondin e pensionit vullnetar dhe kontributet vullnetare të individit për shendetin.....	[16]	
[17]	Shuma e interesit bankar të kredisë së marrë për shkollim	[17]	
[18]	Shpenzimet për mjekim për vete apo për fëmijët dhe për personat në kujdestari për pjesën e pambuluar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor.....	[18]	
[19]	SHUMA E SHPENZIMEVE TË ZBRITSHME (kutia 16 deri 18)		[19]

TATIMI I LLOGARITUR PËR T'U PAGUAR

[20]	Të ardhura të tatueshme (kutia 15 – 19 kur 15>19).....	[20]	
[21]	Shpenzime të pambuluara nga të ardhurat (kutia 19 – 15 kur 15<19).....	[21]	
[22]	SHUMA E TATIMIT TË LLOGARITUR (Kutia 20 x10%)		[22]

TATIME TË PAGUAR GJATË PERIUDHËS TATIMORE

[23]	Tatimi mbi pagën	[23]	
[24]	Tatimi mbi interesat.....	[24]	
[25]	Tatimi mbi qiranë.....	[25]	
[26]	Tatimi mbi dividendin	[26]	
[27]	Tatimi mbi të ardhurat e tjera.....	[27]	
[28]	SHUMA E TATIMIT TË PAGUAR GJATË PERIUDHËS TATIMORE(kutia 23 deri 27)....		[28]
[29]	TATIMI I PAGUAR TEPËR NGA VITI I MËPARSHËM DHE I PARIMBURSUAR....	[29]	
[30]	TATIMI I PAGUAR TEPËR (për rimbursim).....	[30]	
[31]	TATIMI I DETYRUESHËM PËR T'U PAGUAR.....		[31]

Personi Deklarues
(Emri/Mbiemri) _____

Data e deklarimit ____/____/____

Firma _____

UDHËZUES PËR MËNYRËN E PLOTËSIMIT TË DEKLARATËS INDIVIDUALE VJETORE TË TË ARDHURAVE

1. Numri serial përdoret nga drejtoria rajonale tatimore (organi tatimor) dhe shërben për të azhurnuar regjistrimet tuaja kur paraqitet deklarata.
2. **Periudha tatimore** është periudha që përfshin deklarimin nga data 1 janar deri në 31 dhjetor të vitit raportues.

SEKSIONI A: TË DHËNA IDENTIFIKUESE **Të dhëna identifikuese për individin.**

3. **Rezident në Republikën e Shqipërisë.** Plotësohet duke vendosur shenjë "X" në kutinë nëse individit është rezident në Republikën e Shqipërisë.
4. **Jo rezident në Republikën e Shqipërisë.** Plotësohet duke vendosur shenjë "X" në kutinë nëse individit nuk është rezident në Republikën e Shqipërisë.
5. **Emri, atësia, mbiemri, seksi,** plotësohet me të dhënat e individit i cili deklaron me anë të kësaj deklarate, me germa kapitale.
6. **Numri i identifikimit personal sipas letërnjoftimit të deklaruesit** plotësohet sipas numrit që deklaruesi ka në dokumentin e letërnjoftimit ID (në kartën e identitetit).
7. **Adresa kryesore** plotësohet për adresën që deklaruesi ka sipas të dhënave në regjistrin e gjendjes civile.
8. **Qyteti/komuna/rrethi** plotësohet sipas regjistrit të gjendjes civile.
9. **Statusi i deklaruesit** plotësohet duke vendosur shenjë "X" brenda kutive.

Të dhëna plotësuese për individin

10. **Telefon, celular, e-mail,** plotësohet me numrin e telefonit, celularit dhe adresën e e-mailit, që disponon deklaruesi.
11. **Të dhëna mbi pronësinë e banesës kryesore** plotësohet duke vendosur shenjë "X" nëse banesa është në pronësi të deklaruesit me dokumente hipoteke, marrë me qira apo është dhënë falas në përdorim dhe të tjerë.
12. **Emër/mbiemër i pronarit, adresa** plotësohet për emër/mbiemrin e pronarit të banesës dhe adresën e tij, kur deklaruesi është me qira apo pronari ja ka lënë në përdorim falas, e të tjerë.
13. **Adresa e banimit nëse është e ndryshme nga adresa e të dhënave identifikuese.** Adresa e banimit të deklaruesit nëse ka ndryshuar nga adresa e deklaruar në të dhënat identifikuese.
14. **Numri i telefonit, celulari, e-mail,** plotësohet me numrin e telefonit, celularit dhe adresën e e-mailit nëse ka ndryshuar, nga të dhënat identifikuese.
15. **Të dhëna mbi pronësinë e banesës ku jeton,** plotësohet duke vendosur shenjë "X" nëse banesa është në pronësi të deklaruesit, marrë me qira apo është dhënë falas.
16. **Emër/mbiemër i pronarit, adresa** plotësohet për emrin/mbiemrin e pronarit të banesës dhe adresën e tij, kur deklaruesi është me qira apo pronari ia ka lënë në përdorim falas.
17. **Persona nën kujdestarinë e deklaruesit,** plotësohet nga kryefamiljari apo bashkëshortja kur kjo është kryefamiljare duke vënë në kuti, numrin e personave brenda familjes në kujdestari dhe emrin e të tjerë personave në kutinë tjetër.

SEKSIONI : TË DHËNA PËR LLOGARITJEN E TATIMIT

TË ARDHURAT BRUTO

3. **Të ardhurat bruto nga pagat apo shpërblimet nga marrëdhëniet e punësimit për individët,** plotësohet për totalin e pagave dhe shpërblimeve që deklaruesi përfiton nga të gjitha marrëdhëniet e punësimit gjatë periudhës tatimore.
4. **Fitimi nga zhvillimi i veprimtarisë së biznesit të vogël,** plotësohet nga deklaruesi për shumën e fitimit të tatueshëm që deklaruesi i vetëpunësuar, realizon nga veprimtaria e biznesit të vogël me qarkullim mbi 2 000 000 lekë. (kutia 18 e formularit të deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël)
5. **Të ardhurat bruto nga dividendi për pjesëmarrje në shoqëritë tregtare apo nga veprimtaritë e biznesit,** do të plotësohet për shumën e dividendit që deklaruesi përfiton nga të gjitha pjesëmarrjet e tij në shoqëritë tregtare, apo veprimtaritë e biznesit.
6. **Të ardhurat bruto nga qiratë,** do të plotësohet për totalin e të ardhurave bruto që individit realizon nga dhënia me qira e një ose disa objekteve.
7. **Fitimet kapitale nga shitja e pasurisë së paluajtshme (tokë dhe ndërtesë) në pronësi të deklaruesit,** do të plotësohet për fitimin kapital të realizuar në zbatim të nenit 11 të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", te ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.
8. **Të ardhurat bruto nga interesat bankarë** do të plotësohen për totalin e të ardhurave nga interesat bankarë që individit ka përfituar, gjatë periudhës tatimore.
9. **Fitimi kapital neto i krijuar nga investimet në tituj apo nga pasuri të paluajtshme,** do të plotësohet për totalin e fitimeve të realizuara nga investimet në tituj, shitje aksionesh, e pasuri të paluajtshme, përveç se tokë e ndërtesë që janë pasqyruar në kutinë 7. Me termin "fitim kapital i realizuar" kuptohet diferenca ndërmjet vlerës në shitje dhe vlerës në blerje të pasurisë.
10. **Shuma bruto të fituara nga lotari apo lojëra të tjera të fatit,** do të plotësohet për totalin e shumave bruto të fituara nga lotaritë apo lojëra të tjera të fatit.

11. **Të ardhura bruto nga pasuri intelektuale licenca, të drejta ekskluzive dhe pasuri të tjera që përbëhen vetëm nga të drejta dhe që nuk kanë formë fizike,** do të plotësohet për totalin e të ardhurave bruto nga të gjitha, sa përkrahur më sipër.
12. **Fitimet kapitale nga dhurimi** do të plotësohet për shumën e fitimeve kapitale të realizuara nga dhurimi.
13. **Të ardhurat bruto të realizuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë,** do të plotësohet për totalin e të ardhurave bruto të realizuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
14. **Të ardhura bruto të tjera të papërmendura më lart,** do të plotësohet për totalin e të ardhurave bruto të tjera të cilat nuk janë të përfshira në të ardhurat e sipërsënuara.
15. **Shuma e të ardhurave bruto (3-14)** plotësohet për totalin e të ardhurave nga kutia 3 deri në kutinë 14.

SHPENZIME TË ZBRITSHME

16. **Kontributet vullnetare ne fondin e pensionit vullnetar dhe kontributet vullnetare të individit për shëndetin** plotësohet vetëm kur individit ka derdhur kontribut për fondet e pensionit vullnetar në zbatim të ligjit " Për fondet e pensionit vullnetar" dhe kontribute vullnetare për shëndetin.
17. **Shuma e interesit bankar të kredisë së marrë për shkolim për vete apo për fëmijët dhe personat në kujdestari,** do të plotësohet për shumën e interesit bankar të kredisë së marrë për shkolim nga banka brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
18. **Shpenzimet për mjekim për vete apo për fëmijët dhe personat në kujdestari për pjesën e pambuluar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor,** do të plotësohet mbështetur në fakturat e lëshuara nga institucionet shëndetësore brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, për justifikimin e shpenzimeve për mjekim, sipas përcaktimeve në aktet nënligjore.
19. **Shuma e shpenzimeve të zbritshme,** plotësohet për totalin e shpenzimeve nga kutia 16-18.

TATIMI I LLOGARITUR PËR T'U PAGUAR

20. **Të ardhura të tatueshme,** plotësohet për diferencën ndërmjet shumës së të ardhurave bruto (kutia 15) me shumën e shpenzimeve të zbritshme (kutia 19), kur (15 > 19).
21. **Shpenzimet të pambuluara nga të ardhurat,** plotësohet për diferencë kur shuma e shpenzimeve të zbritshme (kutia 19) është më e madhe se shuma e të ardhurave bruto (kutia 15).
22. **Shuma e tatimit të llogaritur** plotësohet për shumën e tatimit të llogaritur që rezulton nga shumëzimi i të ardhurave të tatueshme (kutia 20) me përqindjen e tatimit mbi të ardhurat në masën 10%.

TATIME TË PAGUARA GJATË PERIUDHËS TATIMORE

23. **Tatimi mbi pagën,** plotësohet për shumën e tatimit mbi pagën dhe shpërblimet mbi pagën të paguar gjatë periudhës tatimore. Në rastin e të vetëpunësuarit që kryen veprimtari të biznesit të vogël, kjo kuti plotësohet me shumën e tatimit të paguar nga zhvillimi i kësaj veprimtarie. (kutia 22 e formularit të deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël)

24. **Tatimi mbi interesat** plotësohet për shumën e tatimit mbi interesat bankarë të paguara gjatë periudhës tatimore.
25. **Tatimi mbi qiranë** plotësohet për shumën e tatimit mbi qiranë të paguar gjatë periudhës tatimore.
26. **Tatimi mbi dividendin** plotësohet për shumën e tatimit mbi dividendin të paguar gjatë periudhës tatimore.
27. **Tatimi mbi të ardhurat e tjera** plotësohet për shumën e tatimit mbi të ardhurat e tjera, të listuara në sesionin A dhe të paguara gjatë periudhës tatimore.

28. **Shuma e tatimit të paguar gjatë periudhës tatimore,** plotësohet për shumën e tatimit të paguar nga kutia 23 deri në kutinë 27 të deklaratës.

29. **Tatimi i paguar tepër nga viti i mëparshëm dhe i parimbursuar,** plotësohet për shumën e tatimit të paguar tepër nga vitit i mëparshëm dhe që rezulton i parimbursuar deri në ditën e deklarimit.

30. **Tatimi i paguar tepër (për rimbursim)** plotësohet për diferencën nëse tatimi i paguar gjatë periudhës tatimore (kutia 28) është më i madh se tatimi i llogaritur sipas deklaratës (kutia 22).

31. **Tatimi i detyrueshëm për t'u paguar** (kutia 22 minus kutinë 28 minus kutinë 29) plotësohet për diferencën midis shumës së tatimit të llogaritur sipas deklaratës (kutia 22) minus shumën e tatimit të paguar (kutia 28) minus tatimin e paguar tepër nga viti i mëparshëm dhe i parimbursuar (kutia 29).

Në fund të faqes së parë, të dytë dhe të tretë të vendoset emri, mbiemri, firma e deklaruesit dhe data e deklarimit.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 9.5.2011
Doli nga shtypi më 10.5.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 38 lekë